



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2023/1017

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje nga Vedat Poterqoi - Kryetar, Isa Hasani dhe Vjosa Gradinaj Mexhuani - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) “Schafberger Jr. GmbH” - Dega Kosovë si dhe OE “Efa Dienstleistung GmbH” - Dega ne Kosovë kundër anulimit të aktivitetit të prokurimit, “KK PRISHTINË” në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit “Pastrimi i objekteve shëndetësore të KPSH-se” me numër të prokurimit “616-23-4576-2-1-1”, me 12.03.2024, mori:

Vendim

1. Refuzohen, si të pa bazuara ankesat e OE “Schafberger Jr. GmbH” - Dega Kosovë me nr. 2023/1017, e datës 14/12/2023 dhe ankesa e “Efa Dienstleistung GmbH” - Dega ne Kosovë me nr. 2023/1019, e datës 15/12/2023, kurse vendimi i AK “KK PRISHTINË”, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Pastrimi i objekteve shëndetësore të KPSH-së” me numër të prokurimit "616-23-4576-2-1-1", mbetet në fuqi.

2. Në përputhje me nenin 31 pika 5, të Rregullores së Punës së OSHP-së, konfiskohen tarifat e ankesave në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës, kurse mjetet kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 22.05.2023, “KK PRISHTINË” në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Pastrimi i objekteve shëndetësore të KPSH-së” me numër të prokurimit "616-23-4576-2-1-1".

Ky aktivitet i prokurimit është zhvilluar me procedurë të hapur me llojin e kontratës për shërbim dhe me vlerë të parashikuar të kontratës 1.250.000.00 €

Me 23.11.2023 AK ka publikuar Njoftimin mbi Vendimin B58 përmes të cilit ka anuluar aktivitetin e prokurimit.

Me 27.11.2023, OE “Schafberger Jr. GmbH” - Dega Kosovë ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër Njoftimin mbi Vendimin B58 të Autoritetit Kontraktues. Ndërsa me datën 08.12.2023 AK ka refuzuar kërkesën për rishqyrtim si të pa bazuar .

Me 28.11.2023, OE “Efa Dienstleistung GmbH” - Dega ne Kosovëka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër Njoftimin mbi Vendimin B58 të Autoritetit Kontraktues. Ndërsa me datën 08.12.2023 AK ka refuzuar kërkesën për rishqyrtim si të pa bazuar .

Me 14/12/2023, OE “Schafberger Jr. GmbH” - Dega Kosovë ka parashtruar në OSHP ankesën me nr. 1017/23 ndërsa me datë 15/12/2023 OE “Efa Dienstleistung GmbH” - Dega ne Kosovëka parashtruar në OSHP ankesën me nr. 1019/23.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Gjatë shqyrtimit paraprak të ankesës, Paneli Shqyrtues ka konstatuar se të dy ankesat i përmbajnë të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si të tilla janë parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatorët ekonomik që janë palë të interesuara sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetente për të shqyrtuar këto ankesa sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesave në mënyrë meritore.

Duke marrë parasysh faktin se të dy ankesat janë të ndërlidhura me aktivitetin e njëjtë të prokurimit përkatësisht me njoftimin mbi vendimin e njëjtë të Autoritetit Kontraktues lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, është vendosur që ankesa nr. 1017/23 dhe ankesa nr. 1019/23 të bashkohen dhe të trajtohen si rast i unifikuar në kuptim të nenit 16 paragrafit 1 të Rregullores nr. 01/2020 të Punës së Organit Shqyrtues të Prokurimit.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues “Schafberger Jr. GmbH” - Dega Kosovë janë parashtruar si në vijim:

-Pretendimet e OE ankues: “Pas anulimit të aktivitetit të prokurimit ne kemi ndjekur të gjitha procedurat siç i parasheh Ligji i Prokurimit publik në afatet e parapara ligjore si kemi duke ushtruar të drejtën që na takon me ligj pasi mendoj se AK Komuna e Prishtinës ka bere shkelje ligjore ne vendimin për anulimi të këtij aktiviteti. Ne kemi ushtruar të drejtën ligjore duke bere kërkesë për rishqyrtim ne afatin e parapara me ligj ku edhe është refuzuar me dt.08.12.2023 . Të gjitha pretendimet tona ankimore kanë qe te ilustruar ne Kërkesës për Rishqyrtim por AK si duket nuk i ka marre për bazë. Në njoftimin për anulim të aktivitetit të datës 23.11.2023 ku kemi pranuar edhe letrën standarde të eliminimit ne jemi bazuar ne të gjitha pretendimet e AK se kemi ushtruar të drejtën e mos pajtimit tone sepse ka pas shkelje ligjore. Ne kemi cekur te gjitha aktet

ligjore nen te cilat ka bere shkelje AK dhe nuk jemi ndalur për te argumentuar veç e veç secilin nen pasi ka pasur mjaft argumente të cila ti vërtetojmë këto shkelje. Duke filluar nga neni 1 i LPP-se paragrafët e tij theksohet qëllimi i këtij ligji që ne mënyrë efikase me transparente dhe me të drejtë ti shfrytëzojnë fondet publike dhe të krijoj një kulturë institucionale çka AK me vendim e saj të dt.23.11.2023 ka bere këtë shkelje duke anuluar aktivitetin

Siç është cekur ne Kërkesën për rishqyrtim ne këtë aktivitet ka pasur edhe një vendim tjetër para vendimit te anulimit ku AK ka propozuar Ofertën tone si oferte ekonomikisht me e favorshme dhe e përgjegjshme . Duke pare ecurën e aktivitetin ne kemi pare shkelje të procedurave ligjore na ky Autoriteti prandaj edhe shfrytëzojmë këtë të drejte ankimore. Duke u bazuar ne dosjen e tenderit dhe specifikat teknike ne ofertuar ne baze të kriterit çmimi me i favorshëm duke tenderuar me oferte prej 34,399.06 € çmim mujor dhe 1,238,366.06€ për 36 muaj. Autoriteti Kontraktues “KK.Prishtinë” përkatësisht zyra e prokurimit me dt.14.10.2023 ka dërguar emailin ne adresën zyrtare tonën duke kërkuar dokumentet para shpalljes :Vërtetim tatimor, Certifikatën e Gjykatës Ekonomike dhe Sigurimin e tenderit Origjinal. Me dt.16.10.2023 kemi dërguar dokumentet e kërkuar prandaj me 17.10.2023 ne sistemin e-prokurimit është ngarkuar vendimi i AK për propozimin për kontratë ku si oferte me e favorshme dhe e përgjegjshme ka qene oferta jonë. Për shkak të pranimit të dy kërkesave për Rishqyrtim nga dy OE pjesëmarrës lënda është kthyer ne rivlerësim. Vlen të ceket se dy kërkesat për rishqyrtim kanë pasur pretendime se ju janë bere pa drejtë ne vlerësimin e ofertave të tyre. AK “KK.Prishtinës” duke kthyer ne rivlerësim ketë aktivitet ne procedurat e me tutjeshme ka bere shkelje ligjore të LPP-së dhe rregulloreve tjera të legjislacionit ligjore ne fushën e prokurimit publik. Ne fazën e rivlerësimit është oferta jone është rivlerësuar edhe njëherë nga një komision i vlerësimit qe paska gjetur shkelje të cilat nuk mund të riparohen siç janë gabimet teknike ne dosjen e tenderit për shkak ka quar edhe ne anulimin e tenderit. AK ka vepruar komplet ne kundërshtim me Ligjin e prokurimit duke shkelur nenin 7 Barazinë ne trajtim dhe jo /Diskriminim pasi i ka dhen të drejt OE të cilat kanë bërë kërkesë për rishqyrtim ndërsa ka vepruar ne dem të ofertës sonë. Pas pranimit të kërkesës për sqarim të AK ne kemi kthyer shumë shpejt përgjigje si vijon: Përgjigje për Autoritetin Kontraktues –Kuvendi Komunal Prishtinë Lënda e aktivitetin :Pastrimi I objekteve Shëndetësorë të KPSH-së dhe nr.prokurimi:616- 23-4576-2-1-1 Të nderuar, Se pari si kompani e propozuar për kontratë nga komisioni paraprak i vlerësimi të ofertave shprehim pakënaqësinë tonë pasi lënda ka shkuar në rivlerësim duke e zvarritur procesin. Në këto sqarim shtesë shihet se ka shumë pyetje tendencioze çka bën që të dyshojmë që ka tendenca për të na dëmtuar neve si kompani por edhe të gjithë procesin. Ne do ju përgjigjemi dhe do japim të gjitha sqarimet e nevojshme : Kërkesa për sqarim ne AK:

1. Komisioni i vlerësimit kërkon te sqarohet për mënyrën e kalkulimit te vikendeve, tek kalkulimi I shpenzimeve te kompanisë tek analiza financiare shihet qe kompania kur ta bere kalkulim të ndërrimit te natës me shpenzimet e orëve shtese vetëm për 3 pika, ndërsa sipas dosjes se tenderit- Aneksi 1 tek oraret e ndërrimeve shihet qe janë gjithsej 4 pika me ndërrim te natës. A mund te na sqaroni pse i keni kalkuluar veten 3 pika ne ndërrim te natës dhe jo 4?

Përgjigje: Aneksi 1 ,tabela me oraret e qendrave të KPSH –së shihet se ka gabime ne oraret e qendrave prandaj ne kemi kalkuluar vetëm 3 qendra për shkak edhe te koston sepse ne praktik janë vetëm 3 qendra të cilat janë qe zbatohet ndërrimet e natës : 1.QKMF-Kryesore 2.QMF-4, dhe 3. QMF 5 Ndërsa QMU në dosjen e tenderit ka ndërrim të natës por nuk është zbatuar asnjëherë, i njëjti gabim është edhe të Qendra Stomatologjikë e cila punon vetëm me orarin 07.00- 15.00. Ne deklarojmë që I qëndrojmë mbrapa çdo ndryshimi të orareve në implementimin e kontratës dhe deklarojmë që analiza financiare e jonë I përmbush të gjitha kosto që dalin nga kjo kontratë. Duke marrë parasysh se disa punëtor e po thuaj e themi qe shumica e tyre dëshirojnë pushim pas ndërrimit të natës mendojmë se kostoja jonë e llogaritur ne analizën financiare është kosto e cila përfshinë te gjithë punëtorët të cilët janë ne ndërrim të natës dhe ne qendrat ku zbatohet. Analiza jonë ka përfshirë të gjitha ndërrimet e natës dhe kostoja ka qene ne përputhje me kriteret e tenderit. Sa e kemi kuptuar ne e kemi fjalën në këtë pyetje vetëm për ndërrimin e natës theksojmë se kalkulimet tona janë bërë në bazë të kërkesave të Dosjes se tenderit dhe mendojmë se jemi në rregull sepse nuk ka qendër të 4 ne tabelën e dhëne në këtë dosje te tenderit.

2. Po ashtu kalkulimi I shpenzimeve të orëve të vikendeve nuk ka përfshirë të gjitha pikat e qendrave që punojnë edhe ne vikende por kemi kalkuluar veten 3 pika për vikende. A mund te na sqaroni pse i kemi kalkuluar veten 3 pika për vikende? Përgjigje: Sa I përketë vikendeve ,kalkulimin është bërë në këtë formë për arsye se qendrat punojnë në ndërrimet nga 6h e 30 min. Kjo bënë që një punëtorë mos e kompletojnë komplet 8h në ditë. Prandaj në praktike në për të mbërrit normën e plotë të një ndërrim punohet edhe gjatë vikendeve. Duke aplikuar këtë metode ne kemi bërë që punëtorët të mbërrijnë normën e plotë javore prej 40 ore . Kjo llogaritje e tillë bënë që të ketë kosto me te ulet te shpenzimeve dhe po ashtu është në favor të punëtorëve sepse pasi ne jemi duke e zbatuar edhe në praktik është me favorshme për punëtor . Kalkulimi me vetëm 3 punëtorë për 1 vikend ku gjithsej brenda muaji të jenë 27 vikende të cilat mbulohen të tërë qendrat si dhe punëtorët të arrijnë normën javore e po ashtu edhe te kompensohen për ditët e vikendit në bazë të ligjit.

3. Ju si OE para Vendimit te AK-se ne vlerësimin e pare nga komisioni I pare kemi sjell dëshmi Vërtetimin e ATK-se I cili është ne marrëveshje me këste për shlyerjen e borgjitë. Momenalisht komisioni nuk ka dëshmi bindëse se oferta e juaj ka qene e përgjegjshme ne kohen kur është dorëzuar sepse marrëveshja është dorëzuar pas hapjes se ofertave. A mund te na jepni dëshmi datën e arritjes se marrëveshjes me ATK për shlyerjen e borgjit dhe vërtetimin paraprak të ATK të kohës se hapjes se ofertave qe ju nuk kemi pasur borgje atë kohe. Pikërisht kjo pikë ka qene dhe arsyetimi i AK për anulimin e tenderit çka ka bere qe AK të veprojnë ne kundërshtim me Specifikimet teknike pasi oferta jone i ka mbuluar të gjitha pikat dhe qendrat e KPSH-se ku ne dosjen e tenderit nuk janë caktuar sepse punojnë të gjitha. Kjo si për ne ashtu edhe për OE-të pjesëmarrëse nuk ka paraqitur problem pasi ska pasur as pyje për sqarim . Oferta jonë i ka përfshirë të gjitha pa marrë parasysh normës qe e kemi dhënë 27 vikende janë llogaritur ne muaj dhe janë të mjaftueshme për të gjitha pikat pasi janë gjithsej 17 qendra të cilat mbulohen nga 1 punëtorë ndërsa qendra me flukse me të madh mbulojnë me shumë punëtorë.

4. Përfaqësuesi I autorizuar nga kompania për Trajnimin e sigurisë dhe shëndetit në punë është Valmira Bujupaj, e cila ka qene në të njëjtin rol si staf edhe tek OE Erik, po ashtu I njëjti staf ka qene person I autorizuar në disa marrëveshje ose kontrata me të cilat e ka prezantuar kompaninë Erik, ndërsa për këtë aktivitet ka qene pjesëmarrëse fizikisht për dorëzim të sigurimit për kompaninë Schafberger, duke e patur këtë fakt komisioni ngre dyshime për bashkëpunim mes të dy kompanive, dhe aplikim në të njëjtën procedure, që sipas ligjit të prokurimit publik nuk lejohen bashkëpunime të fshehura. A mund të na njoftoni se çfarë roli ka stafi Valmire Bujupi, a jeni në dijeni se e njëjta punon edhe për një kompani tjetër. Përveç sqarimeve kërkojmë edhe kontratën e punës dhe dëshminë e listës së punëtorëve të deklaruar në ATK. Përgjigje: Znj.Valmira Bujupi është me profesion Juriste dhe është e angazhuar në Kompaninë tonë si Menagjere e projekteve dhe në këtë rast edhe e autorizuar për trajnimin e sigurisë dhe shëndetit në punë. Ne jemi ndër kompanitë me një provoj të gjatë në institucione çka e dëshmon provoja jonë në lëmin e pastrimit e një nder tonë është edhe puna jone pikërisht në institucionin tuaj. Kjo ka bërë që të bashkëpunojmë më shumë Kompani tjera në lëmin tonë e jo vetëm. Sa I përket pyetjes suaj konkretet mbi punëtoreshen tonë në kemi qene në njohuri se herë pas herë Zonja në fjalë ka qene e autorizuar për konzorcimet tona në mes kompanisë Erik Shpk dhe kompanisë sonë si dhe e autorizuar dhe pjesëmarrëse për mbajtjen e Trajnimit për Siguri dhe shëndet në punë duke e dhënë përvojën e saj disa vjeçare në këtë lëmi. Sa I përket Aktivitetit për Pastrimin e objekteve shëndetësore të KPSH-së në përgjegjësi të plotë ju garantojmë se Znj.Valmira Bujupi nuk ka qene pjesëmarrëse në asnjë formë e angazhuar në ndonjë kompani tjetër . Si dëshmi kemi listën e Atk-së 2023 si dhe Kontratën e punës. Një qeshtje tjetër të cilën e ka ngritur komisioni i vlerësimit është komplet e pa bazuar pretendimet të cilat i ka pasur AK për ofertën tonë se gjoa kemi marrëveshje të fshehur me kompani tjetër në këtë aktivitet. Ne kemi ofruar dëshmitë tona të cilat janë dëshmuar me listat ATK dhe kontrate punë për stafin tonë e cila përfshinë vitin 2023 vit ky i cili është zhvilluar edhe kjo procedurë. Punëtorja jonë është juriste me profesion dhe e trajnuar për Siguri dhe shëndet në punë e cila ka ofruar shërbime edhe në kompani tjera në afate të caktuara në vitet paraprake mirëpo në këtë procedure nuk ka pasur asgjë me ndonjë kompani tjetër e aq me pak për këtë aktivitet. Dorëzimi i sigurimit dhe dokumenteve tjera në zyrat e AK nuk përben asnjë dyshim se kjo ka të beje me ndonjë kompani tjetër në këtë procedurë. Nuk kemi kuptuar pretendimin e AK sepse procedura është zhvilluar në vitin 2023 dhe në kemi dorëzuar listat e ATK për vitin 2023. Ne kemi përgjegjësi vetëm për dokumentet e dorëzuara për kompaninë tonë. Ky pretendim nuk qëndron pasi në Letrën standardë nuk është cekur se cilat vite duhet të dorëzohen listat e ATK-së.

5. Kërkesë Përgjigje: Ne kemi analizuar të gjithë dosjen e tenderit me kujdes e po ashtu edhe listën e artikujve dhe sasinë e tyre. Ne dosjen e tenderit është vendosur një listë e përafërte mujore me 32 artikuj të cilët janë të përfshirë edhe mjetet e punës. Ne dosjen e tenderit nuk është kërkuar të vendoset një çmim për çdo artikuj çka kjo na ka bere të qartë se ne e kemi vetëm një sasi të përafërt të materialit hixhenik dhe të mjeteve të punës që shpenzohen në këtë kontratë. Pasi ne jemi duke e implementuar kontratën paraprake e kemi një pasqyrë të qartë për materialin e shpenzuar në të gjitha Qendrat. Duke ja shtuar edhe porosinë e materialit me shumicë dhe bashkëpunimi me shume se 10 vjeçar me furnitorët të tanë dhe ofrimin e materialit me çmime me

të volitshme në bazë të kalkulimeve tonë ne kemi ardhë në përfundim se materiali për këtë aktivitet është 2,084.93 € pa tvsh. Artikujt :13-15 dhe 20-32 janë të gjitha mjete të punës të cilat ne si kompani I posedojmë dhe e kemi një kosto minimale për to sepse për neve do të jetë vetëm vazhdimësi e punës të cilën jemi duke e bërë në KPSH. Paraqitja e një analize tjetër përpos asaj që është kërkuar në dosjen e tenderit do të paraqitet një tjetër arsye që ne të mendojmë se jeni duke zbatuar standarde të dyfishta në lidhje me vlerësimin e ofertave edhe pse ne mendojmë se qëndrojmë shumë mirë me secilin pozicion të analizës financiare të dorëzuar me ofertë dhe të bazuar edhe në dosjen e tenderit dhe në praktikën në teren . Paraqitja e faturave të blerjes është nuk na lejohet për shkak të privatësisë së furnitorëve për arsye se dhe shkon në dem të konkurrencës çka edhe neve nuk na lejohet dhe nuk është pjesë e marrëveshjeve tona me furnitor. Ndërsa çmimi prej shumës :381.77 € nuk dimë për çka është vendosur në pyetjen tuaj prandaj na sqaroni po që se ka të bëjë me ne sepse nuk po e kuptojmë. Ne do ju ofrojmë dëshmitë për përgjigjet që keni dhënë në pyetjet tuaj dhe shpresojmë shumë që të jenë të mjaftueshme për të vendosur edhe njëherë në favor të kompanisë sonë ashtu siç e ka konstatuar një komision paraprak sepse oferta jonë është njëra ndër ofertat më të favorshme e cila është e bazuar në dosjen e tenderit dhe gjendjen praktike në teren pasi tash e sa vite kemi një bashkëpunim ekselent më të gjitha qendrat e KPSH duke ofruar shërbime ekselente në mirëmbajtjen e këtyre qendrave.

Pa marrë parasysh të tërë këtë ju kishim lutur që të jeni profesional ,të paanshme dhe jo diskriminuese në tërë këtë proces të rivlerësimit duke respektuar LPP-në. AK ka rënë në kundërshtim me vetveten pasi na jemi shpallur si kompani fituese me çmim më të ekonomiksht më të favorshëm ka anuluar këtë aktivitet duke shkelur dispozitat ligjore të cekura prandaj edhe nuk pajtohem me vendimin e AK. Për të gjitha argumente e i kemi paraqitur në kërkesën për rishqyrtim duke ngarkuar të gjitha përgjigjet edhe në kërkesën për Rishqyrtim e po ashtu edhe në këtë ankesë për të bindur se përgjigjet tona kanë qenë korrekte dhe të argumentuar për tu pranua nga një AK i cili me një vlerësim paraprak ka vlerësuar se Oferta jonë është e përgjegjshme dhe në pajtim me specifikimet teknike të kërkuara në DT. Pasi komisioni i vlerësimit të kërkesës për rishqyrtim ka konstatuar se Kërkesa jonë nuk ka bazë ligjore dhe logjike në këtë ankesë po i pasqyrojmë me detajsh ato argumente dhe pretendime ligjore të cilat ka bërë shkelje AK. Neni 7 Barazia në Trajtim/Jo diskriminim . AK ka bërë shkelje ligjore të këtij neni duke ju dhënë të drejtë OE -ve të cilën kanë bërë kërkesë për rishqyrtim ndaj vendimi të cilin konstaton ofertën tonë si oferte më të favorshme dhe të përgjegjshme vendim ky i marrë nga vet ky institucion ndërsa tani kur ne kemi shfrytëzuar të drejtën tonë kundër vendimit mbi anulimin vërteton vendimin dhe refuzon Kërkesën tonë si të pa bazë. Këtu shihet qartë se AK nuk ka bërë trajtimin e barabartë dhe jo diskriminues por ka vepruar në kundërshtim me këtë nen. Neni 28 Specifikimet teknike AK ka bërë shkelje të këtij neni pasi pretendon në vendimin e anulimit se në dosjen e tenderit nuk është cekur numri i pikave të objekteve shëndetësore që punojnë në vikende ,po ashtu edhe OE nuk ka bërë pyetje gjatë afatit për sqarimin e tenderit si rrjedhojë OE ka bërë kalkulime të ndryshme në analizën financiare.

Specifikimet teknike kanë qenë të qarta pasi OE nuk kanë bërë pyetje kjo nënkupton se të gjitha OE pjesëmarrëse në bazë të specifikimeve teknike të DT kanë planifikuar në analizat e tyre se si

do ti mbulojnë festat. AK ka bere shkelje të këtij nen i edhe të certifikatë e ISO standardit ku është zëvendësuar me tjetër ku ka ndodhur një gabim sepse Certifikata OHSAS certifikatë 45001 2018 standard ndërkombëtar për menagjimin të shëndetit dhe sigurisë në punë nuk ekziston . Ekziston vetëm OHSAS certifikatë 18001;20017 e cila nuk është me e vlefshme. Certifikata për menagjimin e shëndetit dhe sigurisë në punë është ISO 45001;2018 e cila është dorëzuar me ofertën tonë. Kjo certifikate është vlerësuar nga AK dhe është pranuar ndërsa vikendet nuk janë pranuar edhe pse ne kemi dhen një sqarim dhe një kalkulim te saktë ne ofertën tone. Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve Këtë nen AK e ka shkelur ne te gjitha pikat e vlerësimit te ofertës sonë. Çdo pretendim i AK për të ne shpallur si OE e papërgjegjshme bën shkeljen e këtij neni pasi rregullorja nr.011/2022 për prokurimi publik ne nenin 40 për Ekzaminim, Vlerësim dhe krahasim te tenderëve ne pargarfin10.12 thotë se tenderuesi nuk do të diskualifikohet ose përjashtohet nga procedura e prokurimit në bazë të kërkesës apo kriterit qe nuk është specifikuar ne njoftimin e kontratës/dosjes e tenderit. Nen 62 Përfundimi i aktiviteti AK ka bere shkeljen e këtij neni duke përfunduar aktivitetin ne mënyrë kundër ligjore pasi shkelja për të cilën pretendon nuk qëndron pasi kjo ka qene e riparueshme nr i vikendeve pasi te gjitha pikat punojnë edhe gjate vikendeve dhe oferta jone i ka mbuluar te gjitha objektet dhe per deri sa nuk pas pyetje sqaruese nga OE para hapjes se tenderëve kjo do te thotë se ka qene e kuptueshme për te gjithë OE. Pretendimet se Kërkesa jon e rishqyrtimit ka qene pa bazuar ne aspekte ligjore, përmbajtjesore dhe logjik duke e hedhur si te pa bazuar bën që të shihet qartë se AK ka pasur qellim të na dëmtoj si kompani duke mos na trajtuar te barabartë ne këtë aktivitet dhe duke na dëmtuar dhe duke hedhur fakte të pa baza lidhur me ofertën tonë.”

Duke u referuar te pretendimet si më sipër, OE “Schafberger Jr. GmbH” - Dega Kosovë konsideron se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 1, 6, 7, 28, 59, 62, 72 të LPP.

Përgjigje e AK ne kërkesën për rishqyrtim për OE “Schafberger Jr. GmbH” - Dega Kosovë
“Lidhur me pretendimet ankimore, fillimisht duhet sqaruar se parashtruesi nuk ka arritur te prezantoj asnjë pretendim konkret kundër njoftimit mbi vendimit apo vendimeve te aktivitetit te prokurimit. Parashtruesi thjeshte thotë se nuk pajtohet me arsyet për eliminimin e tij pasi qe sipas tij këto arsye janë te pabazuara. Me fjale te tjera referati i kërkesës për rishqyrtim është shume i përgjithësuar ku manifestohen shume gabime logjike, ligjore dhe gjuhësore të cilat e bëjnë shumë të vështirë identifikimin e pretendimeve ankimore që parashtruesi ka synuar ti prezantoj përmes kërkesës se tij. Pra fakti qe ai nuk pajtohet me arsyet për eliminim nuk përben pretendim ne vetvete. Pretendimi duhet te jete i formuluar sakte dhe ne mënyrë konkrete ne përputhje me nenin
me njoftimet për kontratë dokumentet e tenderit, ose njoftimet dhe vendimet tjera, gjati! kryrjes parashtruesit janë të sakta, te konfirmuara dhe te evidentuara sikurse ne raportin e vlerësimit nga komisioni objektiv dhe profesional ashtu edhe ne letrën standarde për tenderuesin e eliminuar, ne përputhje të plotë me LPP dhe RRPP ne fuqi. Ne anën parashtruesi përmes kërkesës se tij për rishqyrtim nuk ka arritur të formuloj konkrete ankimore sikurse përcaktohet me nenin 59 paragrafin 59.1 te RRPP. Ne ketë drejtim, përmes nenit 62

paragrafit 62.1 nën paragrafit b) të RRPP është përcaktuar se "Autoriteti Kontraktues, respektivisht Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit, do ta refuzojë një kërkesë për rishqyrtim kur kërkesa nuk është paraqitur kundër një njoftimi ose vendimi si, refuzohet në fund duhet të refuzohet si e pabazuar në tërësi duke u bazuar në nenin 62 par. 62.1 nën paragrafit b) lidhur me nenin 59 par. 59.1 të RRPP. Përtej asaj që u tha më sipër, duhet theksuar se parashtruesi përmes kërkesës së tij për rishqyrtim askund nuk i ka kontestuar arsyet për anulimin e aktivitetit të prokurimit. është anuluar në përputhje me nenin 62 të LPP lidhur me nenin 43 të RRPP, për shkak të arsyeve të evidentuara: vendimin B58. Përderisa parashtruesi nuk ka adresuar asnjë pretendim ankimor drejtuar arsyeve për anulimin e aktivitetit të prokurimit, kjo nënkupton që këto arsye përbejnë fakte të pakontestueshme edhe për vet parashtruesin. Në anën tjetër parashtruesi nuk i konteston as të gjitha arsyet për eliminimin e tij si të papërgjegjshëm por vetëm disa prej këtyre arsyeve. Se këndejmi duhet cekur se arsyet e eliminimit të tij janë evidentuar përmes letrës standarde për tenderuesin e eliminuar si në vijim: paraqet letrën standarde për tenderues të eliminuar. Duke marrë parasysh të thënat më sipër, mënyrën e formulimit të pretendimeve ankimore në kërkesën për rishqyrtim, por edhe të gjeturat e komisionit sipas raportit vlerësues është gjetur se oferta e parashtruesit është e papërgjegjshme dhe i njëjti është eliminuar si tenderues. Në këtë mënyrë është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimin e tij. Njëkohësisht nga provat materiale të administruara është gjetur se pretendimi i parashtruesit është tërësisht i pabazuar. Prandaj kërkesa për rishqyrtim është refuzuar si e pabazuar në tërësi.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues "Efa Dienstleistung GmbH" - Dega në Kosovë janë parashtruar si në vijim:

-Pretendimet e OE ankues: "Sipas procesvebali të hapjes së ofertave në pjesëmarrje ishte edhe një OE i cili sipas njoftimit të AK është i papërgjegjshëm edhe pse kishte ofertë me të lirë financiare e njëjta kishte dorëzuar vetëm certifikatën e biznesit dhe paramasën e emimeve andaj nuk mos e vlerësuar që të shkruajm më shumë për këtë ofertë pasi që është oferta jo serioze dhe si e till është vlerësuar sipas njoftimit, vendimit të autoritetit kontraktues është oferta e papërgjegjshme dhe jo serioze.

Autoriteti kontraktues gjatë vlersimit të ofertave në përputhje të paragrafit 1,2 dhe 3 të nenit 72 është dashur të kërkojë informacione shtesë ku thuhet. Nëse një operator dorëzon dokumente të gabuara ose jo të Plota Autoritetet mund të kërkojnë nga operatorët që të dorëzojnë, sqarojnë, plotsojnë apo kompletojnë informacionin dokumentacionin në afat të caktuar.

Po ashtu AK gjatë vlersimit të ofertave ka bërë shkelje të nenit 7 Barzi në trajtim/Jo Diskriminim gjë të cilën shihet qart se AK ka bërë ndaj ofertës duke mos kërkuar asnjë sqarim, ku ndaj të gjithë OE-ve pjesëmarrës ju ka kërkuar informacione shtesë të cilat ishin edhe në kundërshtim me dypozitat ligjore.

Të gjitha këto kërkesa që AK ka bërë për të vlerësuar ofertat të tjera është let e argumentueshme në vendimet e AK. Provë: Vendimet e AK të nënvizuara

Oferta jonë ishte e dyta me radhë më çmimin më të lirë të përgjegjshëm. Bashkangjitur procesverbali i hapjes së ofertave. Provë: Procesverbali i hapjes së ofertave.

Autoriteti kontraktues gjatë fazës së vlerësimit të ofertave ofertën tonë nuk e ka trajtuar drejtë dhe në parimet e dërgimit të Lpp-së dhe aktet ligjore të udhëzuesit nr.001/2023, arsyetimet e dhëna në njoftimin e AK-së lidhur me ofertën tonë nuk mund të konsideroheshin si elemente për të shpallurë ofertën tonë si të pa përgjegjshëm.

-Arsyetimet e dhëna në njoftimin e Autoritetit kontraktues

Kërkesat në dosjen e tenderit ishte: "AK ka kërkuar që operatori ekonomik gjatë 3 viteve financiare 2021/22,23 duhet të ketë së paku 900000,00 euro Qarkullim Financiar, me deklaratat të ATK ose nga një Auditor i Licencuar i pavaruar.

Arsyetimi në njoftim të vendimit të AK-së lidhur me ofertën tonë, duke thënë se: Ju nuk keni plotësuar kërkesën e dosjes 1. Operatori Ekonomik duhet të ofrojë dëshmi të kënaqshme Autoritetit Kontraktues se qarkullimi vjetorë i Operatorit Ekonomik gjatë tre viteve të fundit fiskal ka qenë prej jo më pak se 900,000.00 euro.

Ne bashkë me ofertën tonë kishim prezantuar qarkullimin nga banka ku tejkalohej vlera të cilën keni kërkuar në dosjen e tenderit, o Provë: Raportet bankare të dorëzuara bashkë me ofertën tonë.

Duke u bazuarë në dispozitat e nenit: Neni 68 Gjendja Ekonomike dhe Financiare

18 Autoriteti kontraktues mund të kërkojë nga operatorët ekonomik që të parashtrojnë të dhëna për të treguar se ata i përmbushin kushtet minimale ekonomike dhe financiare të specifikuar në dosjen e tenderit dhe në njoftimin e kontratës. Kur kërkohet, qarkullim minimal vjetor që operatorët ekonomik duhet të kenë nuk do të kalojë vlerën e parashikuar të kontratës. Kërkesat mbi gjendjen ekonomike duhet të shprehën detajshëm në shifra dhe do të referohen maksimum tri viteve të fundit financiare. Kur del veç qarkullimit minimal është i nevojshëm një qarkullim aktual minimal në fushën specifike të mbuluar nga kontrata, qarkullimi i tillë nuk duhet të tejkalojë një pikë pesë (1,5) herë vlerën e parashikuar të kontratës. Në përgjithësi, operatorëve ekonomik u lejohej të plotësojnë këtë kërkesë duke paraqitur, nëse është me rëndësi dhe e nevojshme, një ose më shumë nga referencat e dhëna në vijim:

1.1. raportin ose raportet përkatëse nga një ose më shumë banka; të renditura si në tabel.

1.2. kopjet e certifikuar të një ose më shumë bilanceve të gjendjes ose ekstrakteve nga bilancet e gjendjes nëse kërkohet publikimi i bilanceve të tillë të gjendjes në kuadër të ligjit në vendin e themelimit të operatorit ekonomik; ose

1.3. kopjet e raporteve financiare dhe raporteve të menaxhimit të certifikuara nga një firmë e njohur e licencuar për kontrollim apo një auditor i licencuar i pavarur; ose

1.4. Deklaratat Tatimore Vjetore të dorëzuara në Administratën Tatimore të Kosovës.

Nisur nga të thënat në dipozitat e nenit 68 ne kishim dorzuar qarkullimin nga raportet bankare e cila tejkalon këtë vlerë. Por, autoriteti kontraktues duke mos e trajtuar ofertën tonë sipas nenin 72 paragrafet 1,2,3 që do të mund të kërkonte informacine shtes nga ne gjë të cilën nuk e ka bërë që në faktë ka shkëlur nenit 7 barazia në trajtim dhe diskrimin sepse:Lpp-së neni 68 paragrafi 1 si dhe UDHEZUES Nr. 001/2023 PER PROKURIMIN PUBLII<

10. Sqarimi i tendereve gjate procesit te vleresimit te tendereve 10.1 Shembujt e meposhtem nuk janë të vetmet raste. Mungon dëshmia mbi gjendjen ekonomike dhe financire, mund te kërkojen informata neni 68.

Në mundësin e zbatimit të nenit 68 që thuhet se "Mungon dëshmia mbi gjendjen ekonomike dhe financire", mund të kërkojen informata. Ne kishim të dorzuara qarkullimet bankare që kalonin vlerën e till shumë shumë e që në fakt i bie se kërkesa ndaj nesh për të sqarur këtë pikë ishte mëse e drejt për ofertën tonë. Arsyetimet e dhëna në njoftimin e Autoritetit kontraktues lidhur me standardizimet

Në njoftimin e AK-së është thënë se ju keni prezatuar ISO në gjuhën Gjermane që në fakte është se: Iso standardet e dorzura me ofertën tonë ishin të noterura në Kosovë në gjuhën Shqipe standardetë cilat janë të auditura dhe të lëshuara nga TUV me seli në Gjermani. Iso 14001-2018 dhe Iso 9001-2015.

Iso 45001-2018 është ishte prezantuar në Gjuhën Shqipe dhe e noteruar ndërsa për Iso 14001-2018, Iso 9001- 2015 ishin të prezantuara në Gjuhën Gjermane portë njëjat ishin të notëruara në gjuhën Shqipe. Që pjesa e pasme e fletës është përshkrim detal nga noteri në Gjuhën Shqipe.

- Provë: Iso standartet e përkthyer e të noteruara.

Autoriteti kontraktues kishte kërkuar në dosie të tenderit që:

Kopjim 5. Për piken (a), (b), (c); Te dëshmohet me certifikatat përkatëse për secilën (kopje). SHENIM ME RENDESI - Certifikatat duhet te posedojnë linkun e faqes për verifikim online te validitetit te certifikatave!

Gjë të cilën ne kishim derguar bashkë me ofertën edhe linqet për verifikim. Por, AK duke vepruar në kundërshtim me aktet ligjore primare dhe sekondare ka shpallur ofertën tonë si të papërgjegjshme edhe për këtë pikë që në faktë është në kundërshtim me dispozitat e Lpp-së dhe aktet të tjera sepse:Neni 69Aftësia Teknike dhe/ose Profesionalecertifikatave të hartuara nga institutet zyrtare për kontrollimin e cilësisë ose agjencitë kompetente të pranuar që vërtetoinë përshtatshmërinë e produkteve, që qartazi mund të identifikohen duke u bazuar në specifikimet

dhe standardet përkatëse

Bazuar në dispozitat e LPP-së dhe UDHEZUES Nr. 001/2023 PER PROKURIMIN PUBLIK mungon certifikata ISO , mund te kerkohen informata sqaruese nenin 69

Ne kishim dorzuar dokumentet si Iso 45001-2018 është prezantuar në Gjuhën Shqipe dhe e noteruar ndërsa për Iso 14001-2018, Iso 9001- 2015 ishin të prezantuara në Gjuhën Gjermane portë njëjtat ishin të notëruara në gjuhën Shqipe. Si dhe pjesa e pasme e fletës është përshkrimi detal nga noteri në Gjuhën Shqipe, Në pas njoftimit te autoritetit tuaj ne më datën 17.10.2023 kemi kërkuar interpretim të kriterëve të cilat ishin në dosjën e tenderit, dokumenteve të cilat i kishim prezatuar dhe arsyetimet në njoftimin e Autoritetit Kontraktues Komuna e Prishtinës.

- Provë: Komisioni Rregullativ për Prokurim Publik me datën 27.10.2023 është përgjigjur kërkesës sonë.

Ne posa kemi pranuar intepretim ligjore të Komisioni Rregullativ për Prokurim Publik, u jemi drejtuar me shkresë sqaruese duke sqaruar ne përpikmeri arsyetimet që ju keni dhën në njoftimin e AK-së për ofertën tonë për ta shpallur si të papërgjegjshëm.

- Provë: email zyrtarë derguar AK-së si dhe ngarkimi i dokumenteve në sitemin eprokurimit.

Datës 30.10.2023 Autoriteti Kontraktues pasi që janë paraqiturë disa kërkesa ndaj vendimit të AK-së nga shumë OE, Enda është ri-kthyerë në rivlerësim ne po të njëjtën ditë kemi prezantuar përmes sistemit të e-prokurimit dokumente dhe intepretime ligjore që AK kishte mundësin të rivlerësonte drejtë ofertat.

- Provë dokumentet e dorzuara në AK, kur Enda ishte në ri-vlerësim Pas njoftimit të autoritetit tuaj ne me datën 17.10.2023 kemi kërkuar interpretim të kriterëve të cilat ishin në dosjën e tenderit, dokumenteve të cilat i kishim prezatuar dhe arsyetimet në njoftimin e Autoritetit Kontraktues Komuna e Prishtinës. Komisioni Rregullativ për Prokurim Publik më datën 27.10.2023 është përgjigjur kërkesës sonë ne posa kemi pranuar intepretim ligjore te Komisioni Rregullativ për Prokurim Publik, u jemi drejtuar me shkresë sqaruese duke sqaruar në përpikëmi arsyetimet që ju kani dhën në njoftimin për ofertën tonë për ta shpallur si të papërgjegjshme.

- Dëshmi shkresë për sqarim dhe argumentim të ofertës sone Intepretime i krpp-së;
- Qarkullimi financiare, i përkthyer dhe i noteruar në gjuhën shqipe nga kompania arni në Gjermani;
- ISO standartet sipas kërkesave të dosjës së tenderit te perkthyer dhe te noteruara të njëjtat nga TUV.
- ECURIA E PROCEDURES PASI LENDA ESHTË KTHYER NE RI-VLERESIM

Autoriteti kontraktues gjatë ri-vlerësimit ka cënuar të drejtën tonë si oferta më e firë e përgjegjeshme duke shkelur nenin Neni 7, Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi paragrafet 1, 2, 3, 4, 6.

Si të pa mjaftushme për ju të gjitha keto dokumentë dhe sqarime, duke mos i trajtuar dispozitat ligjore të Lpp-së dhe akteve që ndërlidhën me prokurim publikë.

Më datën 23.11.2023 jemi njoftuar për anulimin aktivitetin në tërsi, duke parë që edhe në procesin e ri-vlerësimit nuk i keni trajtuar ofertën tonë sipas kriterëve dhe dispozitave ligjore primare dhe sekondare të LPP-së,

ARSYETIMET E AK-SË NË NJOTIMIN PËR ELEMENIMIN E AKTIVITETIT

Të thënat në arsyetim nga AIK. Pika 1 "Citim", OE pas vendimit të AK-së ka siell në system disa dëshmi për qarkullim financiarë pasqyra nga kompania Amë në Gjermani. Por sipas komisionit kompania ka ofertuar si e vetme dhe dokumentet tiera nuk janë relevante në ofertën e prezantuar në fillim,

Ne duke u nisur nga e drejta ligjore dhe interpretimi i Komisionit Rregullativ për Prokurim Publikë që kompanit të cilat janë degë e huaj në vendin tonë nuk kanë nevoj të lidhin marrëveshje konsorciumi dhe si të tilla mund të përdorin dokumentet e kompanisë Arnë ne nuk kemi dorzuar marrëveshje konsorciumi në ofertën tonë.

Interpretim ligjore i Krpp-së

Në përputhje me dispozitat e lartë cituara, në rast se një operator ekonomik i cili operon me degët e saja në disa vende (shtete) të tjera, mund të mbështetet në kapacitetet e degëve të saja për ti përmbushë kërkesat lidhur gjendjen ekonomike dhe financiare apo lidhur me aftësitë teknike cilhe/ose profesionale duke ofruar me tender dëshmitë përkatëse dhe për këtë qëllim nuk mund të diskualifikohet i njëjti pse nuk ka marrë pjesë si grup i operatorëve ekonomik.

Të thënat në arsyetim nga AK. Pika 2 "Citim", OE ka siell dëshmi të referencave në gjuhën shqipe vetëm 709,610 euro, të tjerat janë në gjuhën jo zyrtare në gjuhën Gjermane duke bërë shkellie të Lpp-së neni 13 paragrafi 4.

Nisur nga ky parim AK nuk ka pranur dokumentet tona listën e kontratave që ne kishim prezantuar bashkë me ofertën që nga fillimi dhe me plotësim shtesë pas ri-vlerësimit të ofertave. Duke, thënë se ishin në gjuhën Gjermane na befason fakti se si mundet të thuhet një çështje e till ku ne kishim dorzuar listën me referenca të përkthyerë e të noteruar në Gjuhën Shqipe. Kjo gjë forcon bindjen tonë se pretendimi lidhur me parimet ligjore të nenit 7 barazia në trajtim dhe diskriminim është tejet e vertet dhe e fuqishme.

Interpretim ligjore i Krpp-së

Në përputhje me dispozitat e lartë cituara, në rast se një operator ekonomik i cili operon me degët e saja në disa vende (shtete) të tjera, mund të mbështetet në kapacitetet e degëve të saja për

ti përmbushë kërkesat lidhur gjendjen ekonomike dhe financiare apo lidhur me aftësitë teknike dhe/ose profesionale duke ofruar me tender dëshmitë përkatëse dhe për këtë qëllim nuk mund të diskualifikohet i njëjti pse nuk ka marrë pjesë si grup i operatorëve ekonomik.

Të thënat në arsyetim nga AK. Pika 3 "Citim", Operatori duhet të jete i certifikuar sipas standarteve ndërkombëtare të menaxhimit të mjedisit, në lemin e pastrimit të objekteve Iso Certifikatë 14001-2018 valide. Iso standard për menaxhimin e sigurisë dhe shëndetit ne pune-nuk ka sjell aspak.

Kjo e thën e AK nuk është aspak e vertet bashk me ofertën tonë të datës 23.06.2023 kishim dorzuar këtë standard bashkë me linkun e verifikimit nga Rig Cert standard 45001-2018 në Gjuhën Shqipe.

Provë: Intepretimi i Krpp-së

Të thënat në arsyetim nga AK. Pika 3

"Citim", Tek nën kriteret për shpeshhtësin e pastrimit OE është dashur të caktoi sa herë do të intervenoi në një ndrrim prej 1 deri në max 3, ndërsa OE ka dhën shënim 7 here në dite dhe në jave 17 herët drnth OE nuk ju ka përmbaitur te dhënave të AK, aq me shum kur kerni të bëimë me plotësimin të FTD që është kusht administrativ.

Duke nisur nga kërkesa në dosjen e tenderit:8. Operatori ekonomik duhet te paraqet 8. Plani duhet të jetë i nënshkruar dhe i një plan për shpeshhtësisë të pastrimit. vulosur nga Operatori Ekonomik. Ne kishim dorzuar një planë të detajuar lidhur me këtë pikë. Për ne kërkesa e till nuk nenkupton kufizim "sepse atëherë nuk do të ishte logjike poentimi" të numrit se sa hërë duhët të pastrohet apo të intervenohet në hapsira të tilla objekte shëndetësore. Plani që në kemi prezantuar përfshin orarin prej 8 orë punë me një 1 orë pauzë duke renditur orarin e punës Siq është edhe e rregulluar nga ora 07:30 deri në 15:30. I detajuar edhe në pauza të herpes herëshme. Adaj, Siq edhe e kerni prezantuar planin e punës së sherbimeve është arritur numri 7 herë në ditë është tejet normale veprimi në sipas planit në Deklaratët e Shpeshhtësisë që në faktë është dashur ta vlerësoni sipas formules që ishte në dosjen e tenderit në fq. 39, duke i dhën ofetës sone pikët maksimale të poentimit orej 0.30 e që bashkë me çmimin e ofertës sonë do ta arrinim të ishim fitues të kësaj kontratë.

• Provë: Plani i shpeshhtësisë së pastrimit i doruzar me ofertë.

Të thënat në arsyetim nga AK. Pika 4

9. Lista e pajisjeve a) Operatori Ekonomik duhet te ketë te gjitha llojet e makinave për pastrimin e dyshemesë dhe lustrimin 18, b) Makinë për larjen e pllakave 1 (një). c) Makinë për thithjen e ujit4 (katër), d) Makine për larjen dhe terjen e dyshemeve (me akumulator Ose me rryme) 15 (pesëmbëdhjete) e) Kova për pastrim 36 (tridhjetë e gjashte) f) Fshesa me korrent 18 (tetëmbëdhjetë) g) Makine për larjen e tepihëve dhe thithjen e ujit. h) 1 (një) Pikap. i) Makinë (kositëse) me motor për kositjen e barit 6 copa, j) (trimer) 8 copë. k) Makine për largimin e bores (freze) 3 copë • l)Karroce e madhe për pastrim te zyrave, sallave te operimit dhe ambienteve te ngjashme 18 cope m) auto kran me lartësi 25m 1 copë n) Kamionete ose traktor për bartje 1

copë.

Edhe ky arsyetim është i pa saktë sepse bashkangjitur me ofertën kerni prezatuar të gjitha dëshmit duke filluar nga Libreza për automjeteve e makineri, dudu doganorë, marrëveshje të kompanisë, kontrata për furnizim, fatura të blerjes etj.

Për të të saktësuar të thenat tona nga sistemi e-prokurimit si edhe i kerni dorzuar do të u nënvizojm secilën nga pikat në kërkesën e dosjes së tenderit.

Dhe sa i përketë thënjes së AK-së në njoftimin e vendimit tuaj se Traktori është në afat të skaduar "Traktori" nuk është me afat skadence, në këtë renditje të dokumenteve keni pasur të prezanatuar "MARRËVESHJE" të cilat do të mbulonin secilën pikë të kërkuar.

Edhe pikën e traktorit me afatë të skaduar Siq ka thënë AK e kerni të prezantuar marrëveshjen me kamion për bartje të ndryshme që në faktë është më i përshtatëshëm dhe praktik se TRAKTORI destimi i tijë në kundërshtim me funksionimin e shërbimeve dhe bartjeve në kohën e sotme.

Të thënat në arsyetimin nga AK pika 5 "Citim", Tek analiza finaciare OE nuk e ka plotësuar si duhet analizën finaciare sepse nuk e ka bërë Ilogaritëien e festive konform ligjit dhe dosies së tenderit, poashtu kontributet e punëdhënësit e ka Ilogaritur dy herë në kalkulimin e shpenzimeve.

Kërkesa në dosie të tenderit lidhur me kalkulimin e pagave.

Duke u bazur në pjesën e kopjuar nga dosja, lidhur me pagat dhe të drejtat të tjera të të punësuarve NUK është kërkuar që punëtorët të pagohen apo të kryejnë shërbime edhe ditëve të festave, adaj edhe nuk e kemi kalkuar shërbimet në ditë të festave. Analiza finaciare e ofertës sonë është e bazuar në kërkesat e dosies së tenderit.

Ju keni then se ne kemi kalkuar në analizën finaciare dy herë trustin pensional të të punësuarve e vertet që një emërtim në analizën finaciare është mbeturë si emërtimin trustet pensionale. Por, vlera e till nuk mund të konsiderohet gabim pasi që tërsia e ofertës sone e dhën në fund të analizës finaciare dhe në paramasën e çmimev nuk dallon as edhe një 0,01 cent,

Prandaj, vlera e till me emërtim trustet pensionale do të mund të përfshihet në zbatimin, furnizimin dhe pagesa të ndryshme për të ofruar shërbime sa më cilësore për projektin nefjalë apo mund të konsiderohet edhe rritje të pagave të të punësuarve, fitim i mundshëm i kompanisë, furnizime dhe menaxhim. Pranushmëria e saj nuk do të ishte shkelje pasi që vlerat e dhëna nuk përbëjn gabim aritmetik.

Ne lidhur me këtë pikë kerni kërkuar mendimin e Krpp-së për interpretimin ligjorë të padretësis në ofetën tonë e Cila bi në kundërshtim të thelt me dipozitat e Lpp-së nenit 7 barazia në trajtim dhe diskiminim.

Në interpretim duke cituar nderbidhjet e nenëve të dipozitave të Lpp-së të nenit 72 pargrfaret 1, ndërlihur me nenet 65-71 ku është e rregulluar çështja se si AK do të duhet të kërkonte sqarime shtes se do të ishte e nevojshme për të argumentuar në tërsi apo sqaruar ndonjë pa kjarhtësi.

• Provë: interpretimi i Krpp-së i datës 122023

Të gjitha pikat në të cilat është thirrur AK për të shpallur ofertën tonë të papërgjegjshme dokumentet për të cilat ka dhënë arsyetimet e saj. Ekzistenca e tyre ishte e dorëzuar bashke me ofertën tonë ndaj autoriteti kontraktues ka shkelur dispozitat e nenit 72 paragrafi 3.

Duke u referuar te pretendimet si më sipër, Ankuesi "Efa Dienstleistung GmbH" - Dega në Kosovë konsideron se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 1, 4 paragraf 1.26, 6, 7, 53, 59, 60, 68, 69, dhe 72 të LPP-së. Duke propozuar që të aprovohet e bazuar Ankesa e Operatorit ekonomik "Efa Dienstleistung GmbH" Dega në Kosovë për aktivitetin me të dhënat titull: Pastrimi i objekteve shëndetësore të KPSH-së, numër të prokurimit 616-23,4576-2-1-1, dhe lënda të kthehër në ri-vlerësim.

Përgjigje e AK në kërkesën për rishqyrtim për OE "Efa Dienstleistung GmbH" - Dega në Kosovë.

"Operatori ekonomik "Efa Dienstleistung GmbH - Dega në Kosovë" Sh.P.K. (tutje "parashtruesi") me datë 28.11.2023 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit mbi vendimin e datës 23.11.2023 për anulimin e aktivitetit të prokurimit me titull "Pastrimi i objekteve shëndetësore të KPSH-së" me nr. të prokurimit 616-234576-2-1-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (in meritum) të kërkesës.

Pretendimet kryesore të parashtruesit kanë të bëjnë me faktin se parashtruesi i kundërshton të gjitha arsyet për eliminimin e ofertës së tij si tenderues të papërgjegjshme sikurse janë përcaktuar me letrën standarde për tenderuesin e eliminuar si dhe me raportin e komisionit vlerësues.

Duhet theksuar se parashtruesi përmes kërkesës së tij për rishqyrtim askund nuk i ka kontestuar arsyet për anulimin e aktivitetit të prokurimit. Kujtojmë se ky aktivitet i prokurimit përmes njoftimit mbi vendimin e datës 23.11.2023 është anuluar në përputhje me nenin 62 të LPP lidhur me nenin 43 të RRPP, për arsyet e evidentuara si në vijim:

Përderisa parashtruesi nuk ka adresuar asnjë pretendim ankimor drejtuar arsyeve për anulimin e aktivitetit të prokurimit, kjo nënkupton që këto arsye përbëjnë fakte të pakontestueshme edhe për vet parashtruesin

Parimisht parashtruesi nuk i konteston as arsyet për eliminimin e tij si të papërgjegjshëm pasi që me shumicën prej tyre pajtohet (nuk i konteston) si gjendje faktike por vetëm shton se ato nuk përbëjnë arsye të mjaftueshme për eliminim. Si shembull, sa i përket faktit që parashtruesi ka dorëzuar CD për vitet 2020, 2021 dhe 2023 që në total bëjnë 821,000 euro dhe jo 900,000 euro, parashtruesi nuk e konteston faktin që me dosje të tenderit janë kërkuar 900,000 euro dhe as nuk e konteston faktin që sipas dëshmive që ka sjellur ai ka dëshmuar qarkullimin vetëm për 821,000

euro. Konkretisht arsyeja për eliminimin e arashtruesit është formuluar si në vijim: Ju nuk keni plotësuar kërkesën e dosjes 1. Operatori Ekonomik duhet të ofrojë dëshmi të kënaqshme Autoritetit Kontraktues se aarkullimi vjetorë I Operatorit Ekonomik gjatë tre viteve të fundit fiskal ka qenë prej 10 më pak se 900,000.00 eurot OE ka sllë ÇD për vitet 2020, 2021, dhe 2023 që në total bëjnë 821.000 dhe 10 900,000.00.

Megjithatë parashtruesi shton se autoriteti kontraktues ka pasur mundësi që të kërkojë sqarime shtesë duke i dhënë shancë parashtruesit që të dërgojë dokumente tjera shtesë për të përmbushur këtë kërkesë të dosjes së tenderit. Fillimisht duhet potencuar se autoriteti kontraktues nuk është aspak i obliguar që përmes sqarimeve shtesë të mbulojë ose të plotësojë gabimet që i bëjnë tenderuesit me rast-in e dorëzimit të ofertave të tyre tenderuese. Pra kompletimi dhe dorëzimi i ofertave të kompletuara është interes i operatorëve ekonomik ekskluzivisht. Në rastet e parashikuara sipas LPP, autoriteti kontraktues vlerëson dhe ka diskrecionin që të vendosë ose jo për të kërkuar sqarime shtesë. Në rastin konkret nuk janë përmbushur këto kushte sepse dokumentet e dorëzuara kanë qenë të mjaftueshme për komisionin vlerësues që të vendosë në mënyrën si ka vendosur. Kjo vlen edhe për arsyen tjetër të eliminimit respektivisht pretendimit ankimor që ka të bëjë me çertifikatat ISO (shih kërkesën për rishqyrtim). Por edhe po të ishte gjendja faktike ashtu sikurse e pretendon parashtruesi (që nuk është aspak), sërish një veprim i tillë nuk do të kishte logjikë sepse parashtruesi ka dorëzuar ofertë të papërgjegjshme edhe për shumë arsye të tjera. Pra nuk është kjo kërkesa e vetme e dosjes së tenderit që nuk e ka përmbushur parashtruesi por ekzistojnë edhe shumë kërkesa të tjera të evidentuara me raport vlerësues dhe letrës standarde për tenderuesin e eliminuar.

Pra nga mënyra se si është formuluar pretendimi ankimor i cituar si më sipër, lehtësisht mund të konfirmohet fakti se për parashtruesin nuk është kontestuese që i njëjti nuk e ka përmbushur kërkesën e dosjes së tenderit për të cilën po bëhet fjalë (që është kusht administrativ). Parashtruesi vetëm aludon se nuk është arritur të bindet me këtë argumentim të komisionit vlerësues duke thënë se "për ne kërkesa e tillë nuk nënkupton kufizim". Me këtë rast duhet sqaruar se kërkesat e dosjes së tenderit duhet të respektohen tërësisht me rastin e vlerësimit të tenderëve në një aktivitet të prokurimit. Pra qëllimi i dosjes së tenderit nuk është që të bindë një tenderues ose tjetrin por përkundrazi, qëllimi është që tenderuesi të bindë autoritetin kontraktues se e përmbushë kriterin e dhënies së tenderit. Pra nuk mund të thuhet se "kjo për ne nuk përbën kufizim" sepse kufizimet e përcaktuara me dosje të tenderit janë të vlefshme dhe obligative për të gjithë tenderuesit pa përjashtim dhe në përputhje të plotë me parimet e LPP për mosdiskriminim. Sidoqoftë, nuk është kontestuese që parashtruesi nuk e ka plotësuar planin e shpeshëtisë së pastrimit ashtu sikurse është kërkuar me dosje të tenderit prandaj edhe ky pretendim i tij është i pabazuar në tërësi.

Një arsye tjetër për të cilën është eliminuar parashtruesi si tenderues i papërgjegjshëm është edhe kjo si në vijim: Tek analiza financiare OE nuk e ka plotësuar duhet analizën financiare sepse nuk e ka bërë Ilgqaritetin e festive konform liqllit dhe dotes së tenderit, poashtu kontributet e punëdhënësit e ka lloqaritur dy herë në kalkulimin e shpenzimeve.

Kërkesa e dosjes së tenderit për të cilën bëhet fjalë në këtë rast është formuluar si vijon: OE duhet të deklarohet se do të paguan të gjithë punëtorët pagat e njëjta me punëtorët e këtij sektori neto BRUTO prej 300.00 euro me të gjitha obligimet ligjore sipas të Punës Nr.03 L-212 ku duhet të llogaritet së paku pushimi vjetor dhe vikendet si dhe Ilgjeve tjera që rregullojnë marrëdhënien e punës si dhe ATK-se2. a), b) Te dëshmohet me deklarate origjinale të nënshkruara dhe të vëlosur nga OE si dhe analizën financiare të detajuar (origjinale).

Në anën tjetër pretendimi ankimor lidhur me këtë arsye të eliminimit është si në vijim: Duke u bazuar në pjesën e kopjuar nga dosja, lidhur me pagat dhe të drejtat të tjera të punësuarve nuk është kërkuar që punëtorët të paguheshin apo të kryejnë shërbime edhe ditëve të festave, ndaj edhe nuk e kemi kalkuluar shërbimet në ditë të festave. Analiza financiare e ofertës sonë është e bazuar në kërkesat e dosjes së tenderit. Ju kërkohet të na kërkoni në anë të analizës financiare dy herë trustin pensional të punësuarve e vertet që një emërtim në analizën financiare është mbeturë si emërtim i trustit pensional. Por vlera e tillë nuk mund të konsiderohet gabim pasi që tërsia e ofertës.

Pra nga mënyra se si është formuluar pretendimi ankimor i cituar më sipër, parashtruesi pretendon se nuk është kërkuar kalkulimi për vikende, pushim vjetor, festa dhe ditët tjera sipas ligjit të punës në fuqi. Në anën tjetër në kërkesën e dosjes së tenderit ky fakt është përcaktuar shprehimisht siç është cituar edhe më sipër. Sa i përket faktit që është kalkuluar dy herë trusti pensional, parashtruesi as që e konteston këtë fakt por vetëm e cilëson si veprim që nuk është gabim duke aluduar se është emërtim i gabuar. Pra nuk ekziston asnjë dilemë që pretendimi ankimor është i pabazuar në tërësi pasi që de facto arsyeja për eliminim nuk kontestohet as nga vet parashtruesi.

Të pretendimet ankimore të parashtruesit janë ffajtuar dhe shqyrtuar me kujdes nga zyrtari përgjegjës i prokurimit. Me këtë rast është konfirmuar në mënyrë të pakontestueshme që oferta e parashtruesit është e papërgjegjshme dhe me të drejtë është eliminuar si tenderues nga ky aktivitet i prokurimit. Për më tepër është konfirmuar që arsyet për të cilat është anuluar aktiviteti i prokurimit janë arsye të bazuara në tërësi dhe në përputhje të plotë me nenin 62 të LPP si dhe nenin 43 të RRPP (përndryshe ky fakt nuk është kontestuar në asnjë pjesë të kërkesës për rishqyrtim as nga vet parashtruesi).

Duke marrë parasysh të thënat më sipër, mënyrën e formulimit të pretendimeve ankimore në kërkesën për rishqyrtim, por edhe të gjeturat e komisionit sipas raportit vlerësues është gjetur se oferta e parashtruesit është e papërgjegjshme dhe i njëjti është eliminuar si tenderues.”

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Paneli Shqyrtues me datë 22.12.2023 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesave me nr. 1017/23 dhe 1019/23.

Lidhur me ankesën nr. 1017/23 me datë 01.01.2024 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me Nr. 2023/1017 me rekomandimet si në vijim: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura,

eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

Lidhur me ankesën nr. 1019/23 me datë 01.01.2024 është dorëzuar raporti i ekspertës shqyrtuese me nr. 2023/1019 me rekomandimet si në vijim: “Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues refuzohet si e pabazuar.

Raportin e ekspertizës me nr.1017 e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK dhe OE nuk kanë dhënë përgjigje lidhur me rekomandimin e ekspertit shqyrtues.

Raportin e ekspertizës me nr.1019/23 e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK deklaron se pajtohet rreth rekomandimeve të raportit të ekspertit shqyrtues, ndërsa OE nuk pajtohet me raportin e ekspertit shqyrtues.

Paneli shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për të vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore në kuptim të nenit 24 paragrafi 1 të Rregullores së Punës së OSHP-së duke marrë parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtrësit e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritues lidhur me rastin.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertës shqyrtuese, parashtrësit dhe dokumentet e ankuesve, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e OE “Schafberger Jr. GmbH” - Dega Kosovë eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2023/1017 ka vlerësuar si në vijim:

Me datë 23.11.2023 ka nxjerrë Njoftimi i Autoritetit Kontraktues për anulimin e aktivitetit. ku në të njëjtin vendim ka njoftuar edhe tenderuesit të tjerë me letër standarde përmes sistemit E-Prokurim për vendimin e marre. OE “Schafberger Jr. GmbH - Dega Kosove Dega ne Kosove”- Prishtinë ka parashtruar ankesë me 28.11.2023, kundër anulimit të aktivitetit të prokurimit, lidhur me aktivitetin e prokurimit: “Pastrimi i objekteve shendetesore të KPSH-se” me nr. të prokurimit: "616-23-4576-2-1-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Kuvendi i Komunës së Prishtinës. NDERSA Vendimi i AK-së në kërkesë për rishqyrtim të dt 28.11.2023 OE “Schafberger Jr. GmbH - Dega Kosove Dega ne Kosove”- Prishtinë me dt 23.11.2023 .me pas OE i pakënaqur ka parashtruar ankesë pran OSHP me dt 15.12.2023 .Si palë me interes për këtë procedure të prokurimit NUK pajtohem me vlerësimin të pranuar nga AK-ja përmes letrës standarde të tenderuesit të eliminuar dhe vendimit për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim sepse përveç që kemi plotësuar kërkesat e përzgjedhjes po ashtu edhe ato teknike të detyrueshme siç kanë qenë të specifikuar në Aneksin 1 të DT.ANKESA PRAN AK - Autoriteti Kontraktues (AK) – Kuvendi i Komunës së Prishtinës ishte si me poshtë: Kërkesa për Rishqyrtim.

Eksperti shqyrtues i Prokurimit, sipas autorizimit nr: 2023/1017, dhe në pajtim me nenin 114 të LPP-së ka shqyrtuar pretendimet e OE “Schafberger Jr. GmbH - Dega Kosovë”-Prishtinë, dërguar ne OSHP ku pretendon se janë shkelur LPP ne disa nene të poshtëshënuar Neni 1 Qellim. Neni 6 Barazia dhe efikasiteti. Neni 7 Barazia ne trajtim/Jo diskriminim, Neni 28 Specifikimet teknike. Neni 59 Ekzaminim, Vlerësimi dhe krahasimi i tender vë Neni 62 Përfundimi aktiviteti. Neni 72 Dokumentacioni dhe informatat shtese Autoriteti Kontraktues AK KK Prishtinë ne vendimin e nxjerr thekson se OE “Schafberger Jr. GmbH - Dega Kosove Dega ne Kosove”-ne arsyetimin e Vendimit bie ndeshe me fjalët e cekura ne te kur thekson se citoi

Gjate shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se gjetur se kërkesa është e lejuar dhe e parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistoin pengesa tjera për te shqyrtuar kërkesën e parashtruar. Ne këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për vazhduar shqyrtimin meritor të Kërkesës.

Menjëherë po ne të njëjtin vendim thekson se OE ka ber gabime logjike ligjore gjuhësorë etj ne formulime e referateve duke bere shkelje të Neni 59.

Dispozitat e përgjithshme te paragrafit 59.1 të rregullores per Prokurim Publik ka bere shkelje te rregullores nder te tjera rregullorja thekson se 59.1 Sipas Nenit 108/A të ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, kërkesa për rishqyrtim mund të dorëzohet, pa pagese, nga cilado palë e interesuar në çdo fazë të aktivitetit të prokurimit dhe në lidhje me çfarëdo aktiviteti ose lëshimi të autoritetit kontraktues që pretendohet të ketë bërë shkelje në ligjin aktual, apo akteve të nxjerra në zbatim të tij pranë Autoritetit kontraktues i cili udhëheq aktivitetin e prokurimit. Kërkesat për rishqyrtim mund të ndërliidhen me njoftimet për kontratë, dokumentet e tenderit, ose njoftimet dhe vendimet tjera, gjatë kryerjes së aktivitetit përkatës të prokurimit.

59.2 Formularët standard mund të shkarkohen nga ueb faqet e KRPP-së dhe OSHP-së

a. Formulari F01 Formulari Standard për parashtrimin e ankesës në OSHP

b. Formulari F02 Formulari Standard për paraqitje të kërkesës për rishqyrtim tek Autoriteti Kontraktues.

Eksperti Shqyrtues thekson e nëse me te vërtet OE ka shkelur ketë nen AK nuk është dashtë te merret me ankesën e tije ne lëshimet “ne shkrime Gjuhësore sepse nuk kemi te bëjmë me drejtshkrime te OE por me Ligjin e Prokurimit Publik i cili ne as një pik te saji nuk thotë se duhet AK për OE duhet te kenë Referate logjike pa gabime gjuhsore veq se atyre Aritmetike apo tjera.

Eksperti Shqyrtues thekson se është dashtë te eliminoi pa hyr ne pretendimet e tjera Ankimore.

AK Komuna Prishtinë duhet të këtë kujdes kur në të njëjtin vendim thekson se OE i ka plotësuar kushtet për shqyrtim meritot të ankesës dhe pak rreshta me poshtë thekson që ka bërë shkelje të rregullores të nenit 59 dhe nenit 62 paragrafit 62.1.

Eksperti shqyrtues sipas Dokumentit të Ofruar nga platforma elektronike dhe të marra në dosjen e tenderit dhe dokumentacionit Operatorët ekonomikë në platformën elektronike dhe duke u bazuar në pretendimet e dhëna nga Autoriteti Kontraktues për eliminimin e OE ku ka kërkuar në të cilën pretendon që nuk janë të plotësuara të Kapaciteti teknik dhe profesional: Dhe pasi që as njeri nga këto kërkesa nga dosja e tenderit nuk janë kushte Administrativ AK Komuna Prishtinës ka shfrytëzuar Ligji Nr. 04/L-042 PËR PROKURIMIN PUBLIK TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, I ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092 Neni 72 Dokumentacioni dhe informacioni shtesë të bashkangjitura nga OE dhe neneve të poshtë shënuara. Ligji Nr. 04/L-042 PËR PROKURIMIN PUBLIK TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, I ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092 Neni 72 Dokumentacioni dhe informacioni shtesë

1. Kur informacioni apo dokumentacioni që duhet të dorëzohet nga operatorët ekonomikë është ose duket të jetë jo i plotë ose i gabuar, ose kur mungojnë dokumentet specifike, autoritetet kontraktuese mund të kërkojnë nga operatorët ekonomikë që të dorëzojnë, plotësojnë, sqarojnë apo kompletojnë informacionin apo dokumentacionin e duhur brenda një afati të caktuar kohor, me kusht që kërkesat e tilla bëhen në përputhje të plotë me parimet e trajtimit të barabartë dhe transparencës.

2. Autoriteti kontraktues mund të ftojë operatorët ekonomikë për të plotësuar apo të qartësojë certifikatat dhe dokumentet e paraqitura në pajtim me nenet 65-71 të këtij ligji.

3. Sigurimi i informacionit që mungon ose ofrimi i informacionit do të aplikohet vetëm për dokumentet ekzistenca e të cilave është e fiksuar, para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderëve, dhe mund të verifikohet në mënyrë objektive.

Po ashtu rregullorja thekson 10. Sqarimi i tenderëve gjatë procesit të vlerësimit të tenderëve

10.1 Shembujt e mëposhtëm nuk janë të vetmet raste. Varësisht nga rasti i paraqitur AK

duhet të veproj në përputhje me nenin 72 dhe nenin 59 të LPP-së. Kërkesë e dosjes së tenderit

2. OE duhet të deklarohet se do të paguan të gjithë punëtorët pagat e njëjta me punëtorët e këtij sektori në BRUTO prej 300.00 euro me të gjitha obligimet ligjore sipas Ligjit të Punës Nr.03 L-212 ku duhet të llogaritet së paku pushimi vjetor dhe vikendet si dhe ligjeve tjera që rregullojnë marrëdhënien e punës si dhe ATK-se dëshmi 2. a), b) Te dëshmohet me deklarate origjinale e nënshkruar dhe e vulosur nga OE si dhe analizën financiare të detajuar (original).

3. OE duhet të deklarohet se pranon të punësoj 36 punëtor nga lista e AK-se dhe për kryerjen e shërbimeve do të shtoj edhe 40 punëtor nga personeli i tij gjithashtu të deklarohet për pagesën e

përvojës se punës për 36 të punësuar vlera e të cilës është 850 (pa TVSH) dëshmi 3. a) deklaratë origjinal e nënshkruar dhe e vulosur nga OE.

4. Operatori Ekonomik duhet të posedoj minimumin (5) punëtor(staff) të certifikuar për siguri dhe shëndet në punë në përputhshmëri me Ligjin Nr.04 L-161 sipas organogramit të kompanisë. Dëshmi 4. Të dëshmohet me kopje të certifikatave valide dhe organogrami të kompanisë (kopje).

Nr. Përshkrimi teknik objekte QKMF/Sasia objekte QMU/Sasia Totali m² Njësia

1	Pastrimi i sipërfaqeve të brendshme	18280 1100	19380 M ²
2	Pastrimi i sipërfaqeve të jashtme	23653 500	24153 M ²

OE "Schafberger Jr. GmbH - Dega Kosove Dega në Kosovë"- Prishtinë në kërkesën "OE duhet të deklarohet se do të paguan të gjithë punëtorët pagat e njëjta me punëtorët e këtij sektori në BRUTO prej 300.00 euro me të gjitha obligimet ligjore sipas Ligjit të Punës Nr.03 L-212 ku duhet të llogaritet së paku pushimi vjetor dhe vikendet si dhe ligjeve tjera që rregullojnë marrëdhënien e punës si dhe ATK-se " ka deklaruar me deklarata të nënshkruara dhe origjinale se do i përmbahet këtij kriteri e që është vlersues dhe ket gje Autorteti KK Prishtin në formularin e vlersimit e ka shënuar që e ka plotësuar duke e shënuar si i Pajtueshem (shih raportin e vlersimit faqe 9) O.E në analizën financiare të detajuar e ka formuluar në baze të kërkesave të Autoritetit Kontraktues kur ka kërkuar që paga BRUTO prej 300.00 euro me të gjitha obligimet ligjore sipas Ligjit të Punës dhe duhet të ketë 40 punëtor nga personeli i tij dhe 36 të punësuar vlera e të cilës është 850 dhe në baze të kërkesës m² janë 43534 m² dhe në kërkesën e materialit shpenzues për pastrim të objektit të cekur në dosje të tenderit OE "Schafberger Jr. GmbH - Dega Kosove Dega në Kosovë"- krejt analizën financiare e ka mbuluar edhe me deklarata të nënshkruara dhe në Original që nga Deklarata nën betim , Deklaratën përmbajtjes të specifikacionit teknik , Deklaratën mbi të ardhurat deklaratën e pranimit të 36 të punësuar e deri të deklaratën mbi materialet standardeve ECO . Pretendimi i KK Prishtinë se OE "Schafberger Jr. GmbH - Dega Kosove Dega në Kosovë"- nuk e ka bërë analizën komform kërkesave të Dosjes së tenderit nuk qëndron sepse të gjitha pikat janë nga Dosja e tenderit dhe të involvuara në Analizën financiare .dhe operatori Ekonomik nuk mund të ndërhyjë në specifikatën të Autoritetit Kontraktues vetëm duhet të ofertojë në atë se çka është ofruar dhe të bëjë Analizë Financiare e cila është një pasqyrë për ardhjen të çmimit pra nuk është kriter vlersues pra OE në bazë të kërkesave të Dosje të tenderit ku ka kërkuar 76 punëtorë e mbi këtë numër duhet të bëhet analiza AK Komuna prishtinës ka kërkuar sasi të Materiali përafërt shpenzues për një muaj ku nuk ka kërkuar çmim të tyre dhe ka në përshkrimin e çmimit gjithsej 43534 m²!

Nëse ka rrjedhur ndonjë gabim gjatë formulimit të specifikave në dosjen e tenderit të Kontratës Kornizë nga AK keto qeshtje i rregullon nëni 54 paragrafi 54.10 i RREGULLORE Nr.001/2022 PËR PROKURIMIN PUBLIK 54.10 Sasia e parashikuar e specifikuar në dokumentet e tenderit është vetëm sasi indikative. Kurdo që Autoriteti kontraktues specifikon sasinë indikative, Autoriteti kontraktues do të specifikojë në dosjen e tenderit vlerën ose sasinë e kontratës si një prag apo një tavan dhe do të lejojë devijimin prej tij, duke deklaruar

gjithashtu përqindjen e mospërputhjes së lejuar. Mospërputhja e lejuar nuk mund të jetë më e lartë se plus/minus tridhjetë përqind (30%). Nëse AK nuk deklaroi përqindjen e mospërputhjes në dosje të tenderit, atëherë kontrata përfundon me vlerën ose sasinë e kontratës si një prag apo një tavan të vendosur. Nëse AK deklaroi përqindjen e mospërputhjes në dosje të tenderit dhe nëse urdhër blerjet tejkalojnë sasinë totale indikative ose vlerën totale indikative të kontratës publike kornizë (duke përfshirë + tridhjetë përqind (30%), pa marrë parasysh datën origjinale të skadimit të Kontratës Publike Kornizë, kontrata do të ndërpritet automatikisht. Mospërputhja e lejuar plus/minus tridhjetë përqind (30%) vlen edhe për Lote dhe për pozicion/artikull, dhe në rast të arritjes së pragut të lejuar AK nuk mund të bëjë porosi tjera për atë Lot apo pozicion/artikull.

Pra Pretendimi i KK Prishtine se OE “Schafberger Jr. GmbH - Dega Kosove Dega ne Kosove”- nuk e ka bere analizën komfor kërkesave të Dosjes së tenderit nuk qëndron dhe **është i pa bazuar**

Pretendimi i KK Prishtine se se ka bashkëpunim të msheft në mes dy kompanive Konkurruese të Përfaqësuesi I autorizuar nga kompania për Trajnimin e sigurisë dhe shëndetit në punë ku është Valmira Bujupaj, e cila ka qenë në të njëjtin rol si staf edhe tek OE Erik, po ashtu I njëjti staf ka qenë person I autorizuar në disa marrëveshje ose kontrata me të cilat e ka prezantuar kompaninë Erik, ndërsa për këtë aktivitet ka qenë pjesëmarrëse fizikisht për dorëzim të sigurimit për kompaninë Schafberger, duke e patur këtë fakt komisioni ngre dyshime për bashkëpunim mes të dy kompanive, dhe aplikim në të njëjtën procedurë, qesipas ligjit të prokurimit publik nuk lejohen bashkëpunime të fshehura.

Eksperti Shqyrtues thekson se Kontrat nr 2331 DT 02.05.2020 e cila ka përfunduar me dt 01.05.2023 me referencë nr 1653 dt 15.03.2023, e cila është publike në mes këtyre dy kompanive nuk tregon se këto dy kompani janë në bashkëpunim të msheft edhe kur është në pyetje Znj Valmire Bujupaj , as një ligje nuk e ndalon që një punëtor të punoj në dy puna ku njëra është Primare dhe tjetra është sekondare edhe me fort është e Argumentuar se nuk ka bashkëpunim të msheft se në listën e ATK bashke me Kontratën e nënshkrua për vitin 2023 është punëtorë OE “Schafberger Jr. GmbH - Dega Kosove Dega ne Kosove”- Prishtinë .dhe nëse prapë kemi dyshime edhe në ATK për lëshimin e dokumenteve të tilla janë organet tjera që duhet të adresuar.

Pra AK Komuna Prishtinës për dyshime për bashkëpunim mes të dy kompanive, dhe aplikim në të njëjtën procedurë, që sipas ligjit të prokurimit publik nuk lejohen bashkëpunime të fshehura. Dhe OE “Schafberger Jr. GmbH - Dega Kosove Dega ne Kosove” ju ka pergjigjur me Kontrate të nënshkruar dhe Liste të stafit të Dorzuar në Administratën Tatimore të Kosovës ku duket qartë se Valmire Bujupi “Kontrata e Punës”

Pra OE “Schafberger Jr. GmbH - Dega Kosove Dega ne Kosove”- Prishtinë ka ofruar edhe listën e ATK për vitin 2023 ku është e qartësuar se Valmire Bujupi është e Angazhuar si punëtorë e rregullt Dhe sa i përket asai AK ngre dyshime për bashkëpunim mes të dy kompanive, dhe

aplikim ne te njëjtën procedure, qe sipas ligjit te prokurimit publik nuk lejohen bashkëpunime të fshehura janë organet të tjera qe e kane ne kompetenc parandalimin e ketyre dukurive krejt çka OE “Schafberger Jr. GmbH - Dega Kosovë”- Prishtinë është qe me Argumente te mjaftueshme te vërtetoi se Valmire Bujupi është e Angazhuar ne pune Primare ne Kompani duke plotësuar kërkesat e Ak për sqarim dt 21.11.2023.

Pra pretendimet Autoriteti Kontraktues: Kuvendit komunës Prishtinës se OE “Schafberger Jr. GmbH - Dega Kosove”- Prishtinë, ka bashkëpunim te fshehur me kompaninë tjera, Janë të pa Bazuara dhe eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues “Efa Dienstleistung GmbH” - Dega ne Kosovë Ekspertja shqyrtuese përmes raportit nr. 2023/1019 ka vlerësuar se:

Konstatimi i ekspertit shqyrtues: “Me datë 23.11.2023 ka nxjerrë Njoftimi i Autoritetit Kontraktues për anulimin e aktivitetit. ku ne te njëjtin vendim ka njoftuar edhe tenderuesit te tjerë me letër standarde përmes sistemit E-Prokurim për vendimin e marre. OE “Efa Dienstleistung GmbH - Dega ne Kosove”- Prishtinë, ka parashtruar ankesë me 28.11.2023, kundër anulimit të aktivitetit të prokurimit, lidhur me aktivitetin e prokurimit: “Pastrimi i objekteve shendetesore te KPSH-se” me nr. të prokurimit: "616-23-4576-2-1-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Kuvendi i Komunës së Prishtinës. NDERSA Vendimi i AK-së në kërkesë për rishqyrtim të dt 28.11.2023 OE OE “Efa Dienstleistung GmbH - Dega ne Kosove”- Prishtinë me dt 23.11.2023 .me pas OE i pakënaqur ka parashtruar ankesë pran OSHP me dt 15.12.2023. Si palë me interes për këtë procedure të prokurimit NUK pajtohem me vlerësimin të pranuar nga AK-ja përmes letrës standarde të tenderuesit te eliminuar dhe vendimit për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim sepse përveç qe kemi plotësuar kërkesat e përzgjedhjes po ashtu edhe ato teknike te detyrueshme siç kane qene te specifikuara ne Aneksin 1 te DT ANKESA PRAN AK - Autoriteti Kontraktues (AK) – KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES ishte si me poshtë :

Eksperti shqyrtues i prokurimit, sipas autorizimit nr: 2023/1019, , dhe në pajtim me nenin 114 të LPP-së ka shqyrtuar pretendimet e OE “Efa Dienstleistung GmbH - Dega ne Kosove”- Prishtinë ku pretendon se janë shkelur LPP NE DISA NENE SI ME POSHTE Neni 1, Qëllimi, Neni 4, Paragrafi. 1.26. Palë e interesuar Neni 6, Ekonomiciteti dhe Efikasiteti Neni 7, Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi Neni 53 Sigurimi i informatave shtesë për kandidatët dhe tenderuesit Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve paragrafi 3 Neni 60 Kriteret për Dhënien e Kontratës paragrafi 1. Neni 68 Gjendja Ekonomike dhe Financiare Neni 69 Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale Neni 72 Dokumentacioni dhe informacioni shtesë,

Eksperti shqyrtues sipas Dokumentit të Ofruar nga platforma elektronike dhe të marra ne dosjen e tenderit dhe dokumentacionit Operoret ekonomit ne platformën elektronike dhe duke u bazuar ne pretendimet e dhëna nga Autoriteti Kontraktues për eliminimin e OE ku ka kërkuar ne te cilën pretendon qe nuk janë te plotësuar te Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

Dhe pasi qe as njeri nga këto kërkesa nga dosja e tenderit nuk janë kushte Administrativ AK Komuna Prishtinës është dashur te shfrytëzoi Ligji Nr. 04/L-042 PËR PROKURIMIN PUBLIK TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, I ndryshuar dhe plotësuar me Lgjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092 Neni 72 Dokumentacioni dhe informacioni shtesë dhe Interpretimi I Komisionit dt 27.10.2023 Interpretimi i Krpp-së 11.05.2023 te bashkangjitura nga OE dhe neneve te poshtë shënuara Neni 68 Gjendja Ekonomike dhe Financiare

1. Autoriteti kontraktues mund të kërkojë nga operatorët ekonomik që të parashtrajnë të dhëna për të treguar se ata i përmbushin kushtet minimale ekonomike dhe financiare të specifikuar në dosjen e tenderit dhe në njoftimin e kontratës. Kur kërkohet, qarkullim minimal vjetor që operatorët ekonomik duhet të kenë nuk do të kalojë dy herë vlerën e parashikuar të kontratës. Kërkesat mbi gjendjen ekonomike duhet të shprehen detyrimisht në shifra dhe do ti referohen maksimum tri viteve të fundit financiare. Kur përveç qarkullimit minimal, është i nevojshëm një qarkullim i caktuar minimal në fushën specifike të mbuluar nga kontrata, qarkullimi i tillë nuk duhet të tejkalojë një pikë pesë (1.5) herë vlerën e parashikuar të kontratës. Në përgjithësi, operatorëve ekonomik u lejohe të plotësojnë këtë kërkesë duke paraqitur, nëse është me rëndësi dhe e nevojshme, një ose më shumë nga referencat e dhëna në vijim: Ligji Nr. 04/L-042 PËR PROKURIMIN PUBLIK TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, I ndryshuar dhe plotësuar me Lgjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092 Neni 72 Dokumentacioni dhe informacioni shtesë.

1. Kur informacioni apo dokumentacioni që duhet të dorëzohet nga operatorët ekonomikë është ose duket të jetë jo i plotë ose i gabuar, ose kur mungojnë dokumentet specifike, autoritetet kontraktuese mund të kërkojnë nga operatorët ekonomikë që të dorëzojnë, plotësojnë, sqarojnë apo kompletojnë informacionin apo dokumentacionin e duhur brenda një afati te caktuar kohor, me kusht që kërkesat e tilla bëhen në përputhje të plotë me parimet e trajtimit të barabartë dhe transparencës.

2. Autoriteti kontraktues mund të ftojë operatorët ekonomik për të plotësuar apo të qartësojë certifikatat dhe dokumentet e paraqitura në pajtim me nenet 65-71 të këtij ligji.

3. Sigurimi i informacionit qe mungon ose ofrimi i informacionit do të aplikohet vetëm për dokumentet ekzistenca e të cilave është e fiksuar, para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderëve, dhe mund të verifikohet në mënyrë objektive.

Po ashtu rregullorja thekson 10. Sqarimi i tenderëve gjatë procesit të vlerësimit të tenderëve

10.1 Shembujt e mëposhtëm nuk janë të vetmet raste. Varësisht nga rasti i paraqitur AK duhet të veprojnë në përputhje me nenin 72 dhe nenin 59 të LPP-së: Mungon dëshmia mbi gjendjen ekonomike dhe financiare, Mund të kërkojnë informata sqaruese 68.

Pra pretendimet e OE “Efa Dienstleistung GmbH - Dega ne Kosove”- Prishtinë_ ku pretendon se janë shkelur LPP Gjendja Ekonomike dhe Financiare Neni 69 Aftësia Teknike dhe/ose

Profesionale Neni 72 Dokumentacioni dhe informacioni shtesë, Janë te Bazuara.

Eksperti Shqyrtues per pretendimin e AK ne lidhje me formularin e tenderit i cili eshte plotesuar nga OE “Efa Dienstleistung GmbH - Dega ne Kosove”- Prishtinë ne platformen e E-prokurimit te Aneksi 1 Formulari tenderit qe ishte edhe nenkriter i per te cilen tenderin ne fjale e bente tender jo me çmim me te ulet por Kriter me ekonomikishte me te favorshem Kuvendit komunës Prishtinës ne dosjen e tenderit kishte pergaditur nenkriteret e poshteshenuara ne lidhje me kete aktivitet te Prokurimit FORMULAR PËR DORËZIMIN E TENDERIT Pjesa I. Formulari i Tenderit Numër të Prokurimit: 616-23-4576-2-1-1 Titulli i kontratës: Pastrimi i objekteve shëndetësore të KPSH-së Tenderi ekonomikisht më i favorshëm në drejtim të OE “Efa Dienstleistung GmbH - Dega ne Kosove”- Prishtinë ne menyren e poshtshenuar.

4. Ky tender është valid për një periudhë prej ose muaj: ose dite: 120 nga data finale për dorëzim te tenderëve. Gjë qe për mua si Ekspert shqyrtues nuk e plotësuar formularin ne mënyrë te duhure dhe te qarte te kolona 2. Operimi (shpeshtësia e pastrimit të sipërfaqeve sipas paramasës) min. 1herë max 3 herë 0.30

Sikur te ishte e shënuar 7 here ne dite dhe ne jave 49 here ndoshta autoriteti kontaktues e kishte notuar me pike maximale koeficientin 30 apo sikur te ishte shënuar 2.42 here ne dite dhe jave 17 here do ti kishte koeficientin 24 Sipas formulës standarde te poentimit

Prandaj UDHËZUES Nr.001/2023 PËR PROKURIMIN PUBLIK e qartëson shumë mire qe ne këto raste duhet te refuzohet tenderi pa kërkuar sqarime shtese.

Eksperti shqyrtues Konstaton se Pretendimi i AK është i bazuar dhe konstatimi i OE qe thote qe nuk mund te behen Kufizime do te ishte ne rregull sikur nje gje te kishte lan 7 here ne dite dhe 49 here ne jave apo te kunderten 2.4 here ne dite apo 17 here ne jave prandaj kjo e bene qe Formulari i tenderit nuk është plotësuar si duhet dhe Udhezuesi e percakton si kushte Administrativ duke Refuzuar tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm Pretendimi i OE “Efa Dienstleistung GmbH - Dega ne Kosove”- Prishtinë.” për Formularin e Tenderit Është i pa bazuar Bazuar.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues -

Bazuar në shkresat e kësaj lënde dhe qëllimin parësor të ankesës, Paneli Shqyrtues (në përbërje kolegjiale) konsideroi se lidhur me çështjen në rastin konkret, nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, përderisa parashtrësar e palëve dhe veprimet e tyre, përbejnë bazë të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritor. Në këtë rast, Paneli Shqyrtues konstatimet e tij i bazoi kryesisht në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, të cilat mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit, sikurse Ankesat në këtë rast.

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit. Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave,

konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës ka gjetur se ankesat duhet të refuzohen si të pa bazuar dhe të mbetet në fuqi vendimi i AK. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka vendosur për të vërtetuar Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna e Prishtinës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Pastrimi i objekteve shëndetësore të KPSH-së” me nr. të prokurimit: "616-23-4576-2-1-1". Paneli Shqyrtues ka vlerësuar se Autoriteti Kontraktues ka vepruar konform dispozitave ligjore të LPP, pasi që AK ka trajtuar në mënyrë të barabartë dhe jo diskriminuese ndaj OE pjesëmarrës, duke u bazuar në dokumentacionin e prezantuar dhe dëshmitë dëshmuese me pas ka rezultuar se anjëra nga ofertat pjesëmarrëse në këtë aktivitet të prokurimit nuk është e përgjegjshme. Paneli Shqyrtues vlerëson se vlerësimi i tenderit është kryer sipas kërkesave të specifikuara në njoftimin e kontratës dhe dosjes së tenderit. Andaj, Paneli Shqyrtues vlerëson se AK me të drejt ka anuluar këtë aktivitet të prokurimit.

Andaj, paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues, deklarimit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe administrimit të provave në tërësi, e të gjithë aktivitetit të prokurimit të lartë shënuar, konsideron se në shqyrtimin të kësaj çështje do të ndalet vetëm tek pretendimet ankimore që janë përcaktuese sa i përket vendimarrjes meritorë. Andaj PSH do ta elaboroj vetëm pikat ankimore të cilat janë përcaktues në këtë vlerësim të kësaj lënde.

a) *Pohimet ankimore të OE “Schafberger Jr. GmbH - Dega Kosove Dega ne Kosove”.*

Ankuesi (me të dhëna si më sipër) ka atakuar vendimin e cituar si më sipër të AK nga aspekti i eliminimit të tij/saj, ku (sipas) AK tek kalkulimi i shpenzimeve të kompanisë tek analiza financiare shihet që kompania kur ta bere **kalkulim të ndërrimit të natës** me shpenzimet e orëve shtese vetëm për 3 pika, ndërsa sipas dosjes së tenderit- Aneksi 1 tek oraret e ndërrimeve shihet që janë gjithsej 4 pika me ndërrim të natës si dhe arsyeja e eliminimit tjetër se kalkulimi I **shpenzimeve të orëve të vikendeve** nuk ka përfshirë të gjitha pikat e qendrave që punojnë edhe në vikende por keni kalkuluar veten 3 pika për vikende. Lidhur me këtë eksperti shqyrtues vlerëson se O.E në analizën financiare të detajuar e ka formuluar në baze të kërkesave të Autoritetit Kontraktues kur ka kërkuar që paga BRUTO prej 300.00 euro me të gjitha obligimet ligjore sipas Ligjit të Punës dhe duhet të ketë 40 punëtor nga personeli i tij dhe 36 të punësuar vlera e të cilës është 850 dhe në baze të kërkesës m2 janë 43534 m2 dhe në kërkesën e materialit shpenzues për pastrim të objektit të cekur në dosje të tenderit OE “Schafberger Jr. GmbH - Dega Kosove Dega ne Kosove”- krejt analizën financiare e ka mbuluar edhe me deklarata të nënshkruara dhe në Origjinal që nga Deklarata nën betim, Deklaratën përbujtjes të specifikacionit teknik, Deklaratën mbi të ardhurat deklaruar e pranimit të 36 të punësuar e deri të deklaruar mbi materialet standardeve ECO. Pretendimi i KK Prishtinë se OE “Schafberger Jr. GmbH - Dega Kosove Dega ne Kosovë”- nuk e ka bere analizën komfor kërkesave të Dosjes së tenderit nuk qëndron sepse të gjitha pikat janë nga Dosja e tenderit dhe të involvuara në Analizën financiare dhe operatori Ekonomik nuk mund të ndërhyjnë në specifikat të Autoritetit Kontraktues vetëm duhet të ofertojë në atë se çka është ofruar dhe të bejë Analizë Financiare.

Paneli shqyrtues nuk e mbështet arsyeshmërinë e ekspertit shqyrtues i cili nuk e vlerëson dhe argumenton një konstatim të tillë dhe nuk e merrë për bazë fare Aneksin e 1 të Dosjes së Tenderit, kërkesën për informacion shtesë të AK drejtuar ankuesit për mes platformës së e-prokurimit të datës 17.11.2023, si dhe përgjigjen e ankuesit lidhur me këtë se "1, *Tabela me oraret e qendrave të KPSH –së shihet se ka gabime në oraret e qendrave prandaj në kemi*

kalkuluar vetëm 3 qendra për shkak edhe te koston sepse ne praktik janë vetëm 3 qendra të cilat janë qe zbatohet ndërrimet e natës : 1.QKMF-Kryesore 2.QMF-4, dhe 3. QMF 5 Ndërsa QMU në dosjen e tenderit ka ndërrim të natës por nuk është zbatuar asnjëherë, i njëjti gabim është edhe të Qendra Stomatologjikë e cila punon vetëm me orarin 07.00- 15.00. Ne deklarojmë që I qëndrojmë mbrapa çdo ndryshimi të orareve në implementimin e kontratës dhe deklarojmë që analiza financiare e jonë I përmbush të gjitha kosto që dalin nga kjo kontratë. Duke marrë parasysh se disa punëtor e po thuaj e themi qe shumica e tyre dëshirojnë pushim pas ndërrimit të natës mendojmë se kostoja jonë e llogaritur ne analizën financiare është kosto e cila përfshinë te gjithë punëtorët të cilët janë ne ndërrim të natës dhe ne qendrat ku zbatohet. Analiza jonë ka përfshirë të gjitha ndërrimet e natës dhe kostoja ka qene ne përputhje me kriteret e tenderit, 2. Sa I përketë vikendeve ,kalkulimin është bërë në këtë formë për arsye se qendrat punojnë në ndërrimet nga 6h e 30 min. Kjo bënë që një punëtorë mos e kompletojnë komplet 8h në ditë. Prandaj në praktike në për të mbërrit normën e plotë të një ndërrim punohet edhe gjatë vikendeve. Duke aplikuar këtë metode ne kemi bërë që punëtorët të mbërrijnë normën e plotë javore prej 40 ore . Kjo llogaritje e tillë bënë që të ketë kosto me te ulet te shpenzimeve dhe po ashtu është në favor të punëtorëve sepse pasi ne jemi duke e zbatuar edhe në praktik është me favorshme për punëtor . Kalkulimi me vetëm 3 punëtorë për 1 vikend ku gjithsej brenda muaji të jenë 27 vikende të cilat mbulohen të tërë qendrat si dhe punëtorët të arrijnë normën javore e po ashtu edhe te kompensohen për ditët e vikendit në bazë të ligjit." Andaj, vlerësimi, ekzaminimi dhe krahasimi i tenderëve duhet të bëhet konform kërkesave të Dosjes së Tenderit, me çrast AK analizën financiare e ka kërkuar tek kriteret e përzgjedhjes Dëshmia Nr. 2 2. a), b)Te dëshmohet me deklarate origjinale e nënshkruar dhe e vulosur nga OE si dhe analizën financiare te detajuar (origjinal). Analizë kjo e cila duhet të përpilohet konform specifikimit teknik duke përfshirë nr. e punëtorëve, pagat e tyre, kalkulimi i orëve, etj. Në bazë të përgjigjes së OE ankues ndaj kërkesës së AK, Paneli Shqyrtues vlerëson se kjo përgjigje me të drejtë nuk është e pranuar nga AK. Çdo OE ankues me qëllim që të jetë i përgjegjshëm duhet të ofertoj konform kërkesave të Dosjes së Tenderit, nëse eventualisht Dosja e Tenderit përmban gabime atëherë OE duhet mos ti pranoj si të tilla dhe të njëjtat ti atakojë me Kërkesë për Ri-shqyrtim dhe Ankesë në OSHP. Në momentin e ofertimit atëherë OE zotohet se i pranon të gjitha kushtet dhe kërkesat e DT pa ndonjë kufizim , këtë veprim e realizon përmes Formularit të Dorëzimit të Ofertës që është pjesa kryesore e Ofertës (Formular ky i bashkangjitur në ofertën e ankuesit). Rrjedhimisht OE ankues për këtë aktivitet të prokurimit është i papërgjegjshëm.

b. Pohimet ankimmnore të OE "Efa Dienstleistung GmbH - Dega ne Kosove".

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit. Argumentimi në raportin e ekspertit është mjaft i detajuar, i kuptueshëm dhe i bazuar tërësisht dokumentet relevante që i referohen aktivitetit të prokurimit përfshirë të gjitha shkresat e lëndës nga të gjitha palët në procedurë dhe e mbështet arsyeshmërinë dhe rekomandimin e Ekspertit Shqyrtues, pa nevojë që të njëjtat të përsëriten edhe njëherë. Paneli Shqyrtues po ashtu, mori për bazë edhe arsyet e eliminimit të OE ankues tek njoftimin mbi vendimin e AK si dhe përgjigjen e AK. Pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës, paneli shqyrtues sqaron se aktiviteti i prokurimit është anuluar në mungesë të ofertave të papërgjegjshme e që në këtë rast OE ankues nuk ka arritur të argumentoj me prova bindëse se është i përgjegjshëm për këtë aktivitet të prokurimit.

Përfundim

Andaj, Paneli shqyrtues vendos ti jep të drejtë AK dhe që ta lë në fuqi vendimin e AK, vendim ky i cili është nxjerrë nga një komision i vlerësimit i cili supozohet të jetë profesional dhe po ashtu përgjegjës sipas nenit 59.1 cituar të gjithë anëtarët e Komisionit Vlerësues marrin përgjegjësi të plotë individuale për vlerësimin e kryer të ofertës. Paneli Shqyrtues thekson se secili autoritet kontraktues (në nivelin qendror dhe lokal) gëzon autonomi në planifikimin e prokurimit (neni 8) dhe në përcaktimin e nevojave që duhen përmbushur (neni 9), natyrisht në pajtim me kapacitetin buxhetor dhe se AK në rastin konkret ka pasur të drejtë të vendos po ashtu edhe për anulimin e aktivitetit të prokurimit bazuar edhe në neni 24 paragrafi 2 të LPP cituar "Autoriteti kontraktues është përgjegjës për të siguruar që të gjitha aktivitetet e prokurimit të autoritetit të tillë kontraktues të ekzekutohen në përputhshmëri të plotë me këtë ligj".

Kthimi i një aktivitetit të prokurimit pa bazë kontestuese ligjore në ri-vlerësim, nuk është në harmoni me nenin 1, të LPP, sipas të cilit, qëllimi i këtij Ligji është mes tjerash, cituar: "...të siguroj integritetin dhe përgjegjësinë e zyrtarëve publik, nëpunësve civil dhe personave të tjerë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit duke kërkuar që, vendimet e individëve të tillë dhe baza ligjore e faktike për vendimet e tilla, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jo-diskriminim dhe me një shkallë të lart të transparencës dhe, të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji".

Prandaj duke vepruar mbi bazën e parimeve themelore të procedurave për shqyrtimin e prokurimit, të cilat mes tjerash, janë sanksionuar në mënyrë të veçantë me dispozitën e nenit 104, të LPP dhe njëherësh duke i analizuar shkresat e kësaj lënde në relacion me faktet dhe rrethanat e përshkruara si më sipër, e posaçërisht duke i kushtuar kujdesin e duhur po ashtu dhe natyrës dhe qëllimit të pretendimeve ankimore, Paneli Shqyrtues mori në konsideratë të gjitha pohimet e ankuesit, aktet dhe veprimet e ndërmarra nga AK, raportin e ekspertit shqyrtues dhe i analizoi me kujdes të gjitha shkresat e kësaj lënde dhe konsideron se pohimi ankimor i OE ankues është i papabazuar dhe refuzohet, ashtu siç janë dhënë në konstatimet e panelit.

Paneli shqyrtues në këtë vendim marrje ka pasur në konsideratë edhe kërkesat e nenit 104, paragrafi 4 të LPP, sipas të OSHP duhet të veprojnë sa më shpejtë që të jetë e mundshme, të veprojnë në mënyrë proporcionale me shkeljen e pretenduar ose çështjen për të cilën është paraqitur ankesa, dhe të marrë për bazë pasojat e mundshme të veprimeve ose masave në të gjitha interesat që mund të dëmtohen, duke përfshirë interesin publik.

Andaj, duke vepruar në pajtim me kompetencat e cituara si më sipër dhe nenin 104 paragrafi 4 lidhur me paragrafin 1, sipas të cilit procedura e shqyrtimit të prokurimit do të zbatohet dhe realizohet në mënyrë të shpejtë, të drejtë dhe pa diskriminim, që ka për qëllim zgjidhjen e ligjshme dhe efektive të lëndës, si dhe duke ju referuar nenit 117 të LPP-së, dhe në provat e prezantuara si më lartë Paneli Shqyrtues vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Vedat Poterqoi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES, KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES**
- **OE - Schafberger Jr. GmbH - Dega Kosovë Dega në Kosovë, Efa Dienstleistung GmbH - Dega në Kosovë**
- Arkivës së OSHP-së: